

Analiza të Politikave

Mitrovica: Një Qytet, Dy Realitete

17 Dhjetor 2009

Këto analiza të politikave janë përpiluar me përkrahjen zemërgjerë të Iniciativës për Reforma në Qeverisje Lokale dhe Shërbim Publik (LGI)



Copyright ©IKS

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
QEVERISJA E ÇRREGULLT E MITROVICËS	5
EKONOMIA NË MITROVICË	13
ARSIMI NË MITROVICË	24
SHËNDETËSIA NË MITROVICË	34
PROÇESI I KTHIMIT NË MITROVICË	43
TRASHËGIMIA E MITROVICËS: PASURI E PËRBASHKËT APO BARRË?	54

HYRJE

Në ballafaqimin politik mes Prishtinës e Beogradit se kush e kontrollon dhe qeveris Kosovën në veri të lumit Ibër, qytetarët e Mitrovicës harrohen lehtë. Deri më sot debati mbi Mitrovicën është përqendruar në çdo gjë përveç se në nevojat dhe brengat e përditshme të qytetarëve. Shumë pak dihet për nevojat e përditshme të njerëzve atje dhe sesi realitetet në veri dhe jug të lumit Ibër dallojnë dhe përngjajnë.

Për këtë arsye IKS-i ka marrë përsipër të identifikojë ‘realitetin’ në terren nëpërmjet analizave skenuese. Ekzistojnë shumë nevoja të përbashkëta që mund të shërbejnë si bazë për një lloj tjetër dialogu mes dy komuniteteve – një dialog që bashkon e jo ndarës.

Këto gjashtë analiza të politikave mëtojnë të kontribuojnë pikërisht në këtë lloj debati. Çfarë ka demaskuar hulumtimi është se këto gjashtë lëmi prekin pa dallim jetën e njerëzve. Në Mitrovicë të diplomuarit nga universiteti si ndeshen me papunësi dhe pakënaqësi, ikin nga qyteti. Shqiptarët ikin në Prishtinë në kërkim të një pune dhe një jete më të mirë, ndërsa serbët, po për të njëjtat arsye, ikin për Serbi. Në cilindo rast, Mitrovica po braktiset nga njerëzit që pretendojnë se janë të gatshëm ta mbrojnë atë me jetën e tyre.

Si duket, armiku më i madh i Mitrovicës nuk është ndarja etnike por papunësia, varfëria, mungesa e perspektivës ekonomike dhe shërbimet e varfëra publike, mes të tjerash. Të gjitha këto së bashku e bëjnë jetën të padurueshme në këtë qytet, dikur më i industrializuari në Kosovë. Ndarja e zonës natyrale ekonomike ka rezultuar në dy tregje të vogla të tkurrura duke detyruar shumë biznese në të dy anët që të mbyllen. Fëmijët e Mitrovicës mësojnë në shkolla me tri ndërrime, pa laboratore, ku marrin arsim të dobët. Qyteti i ndarë ka edhe një problem tjetër të përbashkët: helmimin me plumb. Mitrovica është përshkruar nga OBSH-ja si “një prej katastrofave me plumb më serioze shëndetësore ambientale në botë dhe histori.” Edhe pse institucionet e shëndetësisë vazhdojnë të jenë të ndara, problemet e shëndetësisë vazhdojnë me këmbëngulësi të qëndrojnë të bashkuara.

Megjithë problemet e sipërpërmendura, qëllimi nuk është të dëshmohet sesi jeta në Mitrovicë është e zymtë dhe e pashpresë. Përkundrazi, qëllimi është që të tregohet se për problemet e përbashkëta ekzistojnë zgjidhje të përbashkëta dhe përtej politikës dhe retorikës së përditshme ekzistojnë baza të përbashkëta, sado të vogla, për bashkëpunim. Këto analiza përmbajnë sugjerime si t’i jepet shtytje ekonomisë; si të integrohet sektori i shëndetësisë; si të rritet besimi i ndërsjellë dhe të lehtësohet kthimi; hapa për arsim më të mirë; si të përmirësohet qeverisja, për të përmendur vetëm disa prej tyre. Qeveria e Kosovës duhet të jetë më kategorike në trajtimin e nevojave të qytetarëve të Mitrovicës. BE-ja duhet të tregojë lidërsip të vendosur dhe të rrisë dukshmërinë e saj në veri.

Problemet në Mitrovicë janë të thella dhe, në një perspektivë më të gjerë, ato janë edhe problemet e Kosovës dhe mund të themi edhe të regjionit, prandaj edhe shumë të vështira për t'u zgjidhur. Kështu përmes këtyre analizave, IKS-i shpreson të kontribuojë në mënyrë modeste në zgjidhjen e problemeve të përditshme konkrete të qytetarëve të Mitrovicës larg nga politika e të fortëve. Këto gjashtë skenime janë vetëm maja eajsbergut përmes të cilave ne shpresojmë të hapim rrugën drejt një debati kuptimplotë.

QEVERISJA E ÇRREGULLT E MITROVICËS

Diskutimet rreth gjendjes dhe zhvillimeve politike në Mitrovicë zakonisht përqendrohen në urën e famshme e cila e ndan qytetin në pjesën veriore dhe atë jugore. Mediat janë përplot me pamje të armëve, trazirave, sigurisë, KFOR-it, Zyrës Civile Ndërkombëtare (ZCN), EULEX-it, Beogradit, Brukselit dhe Uashingtonit. Megjithatë, debatet ndërkombëtare dhe “politikave të mëdha” janë aq larg nga jeta e përditshme e njerëzve që jetojnë në Mitrovicë sa që ato duken si fantazi shkencore.

Në përgjithësi, duket se qytetarët e Mitrovicës janë të brengosur me diçka që në fakt është shumë më themelore: qeverisja komunale. Kush i përfaqëson interesat e qytetarëve të Mitrovicës? Sa janë të kënaqur qytetarët me performancën e udhëheqësve të zgjedhur? A mendojnë njerëzit që prioritetet e tyre po trajtohen në mënyrë adekuate? Ky punim shikon përtej politikave të mëdha dhe futet më thellë në çështjen e qeverisjes komunale në Mitrovicë dhe shikon se si ndikon kjo qeverisje në jetën e përditshme të njerëzve.

Ngatërrimi i kompetencave

Në pajtim me Aneksin III të Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i përgatitur nga i Dërguari i Posaçëm i Organizatës së Kombeve të Bashkuara Martti Ahtisaari, dy komunat e reja të Mitrovicës Veriore dhe Mitrovicës Jugore duhet ta zëvendësojnë komunën aktuale të vetme të Mitrovicës.¹ Përveç kësaj, një *Bord i Përbashkët* i cili i përfaqëson të dy komunat e reja “duhet të themelohet për të kryer bashkëpunim funksional në fushat e kompetencave të tyre në bazë të marrëveshjes në mes të dy komunave.”² Tani për tani, nuk ekziston as Bordi i Përbashkët e as dy komunat e reja. Në vend të kësaj, qeverisja komunale në Mitrovicë përfshin një gamë të tërë akterësh të cilët ushtrojnë autoritet dhe shtyhen për pushtet.

Mitrovica Jugore qeveriset nga Komuna e Mitrovicës, e cila operon nën ombrellën e Republikës së Kosovës në pajtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të vitit 2007. Në anën tjetër, qeverisja në pjesën veriore të Mitrovicës është më komplekse; së paku tri struktura qeverisëse shpeshherë shtyhen për pushtet atje.

Së pari, në vitin 2002, u krijua Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë (AUM) në bazë të Urdhërësës Administrative Nr. 2002/26. AUM është përgjegjëse për territorin e pjesës veriore të Mitrovicës, dhe mban përgjegjësitë e njëjta me komunat e tjera të Kosovës. AUM formalisht financohet nga Komuna e Mitrovicës e cila gjendet në pjesën jugore të qytetit. Rreth 17 përqind e buxhetit të Komunës së Mitrovicës, që buron nga Buxheti i

¹ Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Letër e datës 26 mars 2007 nga Sekretari i Përgjithshëm për Kryesuesin e Këshillit të Sigurimit,” S/2007/168/Add.1, 26 mars 2007, “Propozimi Gjithëpërfshirës Zgjidhjen e Statusit të Kosovës,” Shtojca III, Neni 13.1. Mund të gjendet në: http://www.unosek.org/docref/Comprehensive_proposal-english.pdf.

² *Po aty*, Neni 13.2.


Kosovës, i ndahet çdo vit AUM-it.³ Tetë departamentet dhe 123 anëtarët e stafit të AUM-it i raportojnë drejtpërsëdrejti UNMIK-ut. Ata nuk i japin llogari qytetarëve të pjesës veriore apo jugore të Mitrovicës. AUM-i mbetet në Mitrovicë si një lloj kompromisi, sepse nuk ka trup tjetër të zgjedhur legjitim.

Strukturat paralele komunale serbe janë një trup tjetër qeverisës në pjesën veriore të Mitrovicës. Këto struktura u krijuan pas zgjedhjeve lokale të Serbisë më 11 maj të vitit 2008, dhe ato operojnë në pajtim me Ligjin Serb për Qeverisje Lokale. Edhe pse Serbia kishte organizuar zgjedhje parlamentare në Kosovë disa herë pas vitit 1999, kjo ishte hera e parë që zgjedhjet lokale paralele mbaheshin në Kosovë, për të cilat UNMIK-u asokohe deklaroi se ishin kundër Rezolutës 1244 të Kombeve të Bashkuara.

Së treti, sipas ligjeve të Republikës së Kosovës, pjesa veriore e Mitrovicës formalisht mbetet nën juridiksionin e njejtë si Mitrovica jugore, duke formuar kështu një komunë të vetme. Përkundër shtojcave të lartpërmendura të Planit të Ahtisaarit, krijimi i komunës së re të Mitrovicës Veriore pret mbajtjen e zgjedhjeve lokale, të cilat parashihet të mbahen në pjesën veriore në 16 maj të vitit 2010, në pajtim me ligjet e Republikës së Kosovës.

Gama e akterëve që pohojnë përgjegjësi në pjesën veriore të Mitrovicës i kontribuon edhe më tej ngatërrimit ekzistues të kompetencave. Qytetarët nuk e dinë kujt t'i drejtohen për çështjet dhe brengat e tyre, e as nuk dinë prej kujt të kërkojnë përgjegjësi. Në fakt, kur Inicijativa Kosovare për Stabilitet (IKS) i pyeti banorët e veriut se kush është “në krye” të Komunës së Mitrovicës, ata shprehën kundërshtime të konsiderueshme.⁴ Siç ilustron grafikoni 1 më poshtë, 22 përqind prej tyre mendojnë që Qeveria e Serbisë është në krye të kësaj komune.

Grafikoni 1. Mendimi i Qytetarëve të veriut se 'Kush është në krye' të Komunës së Mitrovicës



³ Në vitin 2009, €2,594,566 janë ndare nga Qeveria e Kosovës për AUM, përndryshe kjo shumë është 26% e shumës totale të garteve qeveritare (€9,967,115) të alokuara për Komunën e Mitrovicës.

⁴ Studim i IKS, Mitrovica veriore, gusht 2009.


Më tepër respondentë mendojnë që Serbia ka më tepër kontroll sesa autoritetet komunale; vetëm 19 përqind e respondentëve mendojnë që autoritetet komunale janë “në krye” të komunës. Numri i njejtë i respondentëve (19 përqind) mendon që krimi organizuar e qeverisës komunën. 20 përqind prej tyre mendojnë që UNMIK-u është në krye, derisa 8 përqind mendojnë që bashkësia ndërkombëtare (EULEX dhe ZCN) i mban “frenjtë” e komunës. Një përqindje e mjaft e madhe prej 21 përqind nuk ishin të sigurtë se kush është në krye të komunës së tyre. Por duke marrë parasysh morinë e hisedarëve, a mund t’i fajësojmë ata?

Qytetarët humbin në mes të lojës së fajësimit, ku të gjithë akterët e lartpërmendur *pohojnë* përgjegjësi por asnjeri prej tyre *nuk merr* përgjegjësi për adresimin e nevojave konkrete të qytetarëve. Përveç kësaj, mungesa e autoritetit të qartë në Mitrovicë duket se po krijon një boshllëk të cilin krimi i organizuar është më se i gatshëm ta mbush. Nevoja akute për qartësimin e kompetencave qeverisëse në veriun e Mitrovicës është më se e qartë. Qytetarët duhet të dinë se cili trup është përgjegjës për trajtimin e prioriteteve të tyre dhe duhet të jenë në gjendje të kërkojnë llogari prej atij mekanizmi.

Meqë asnjeri nga mekanizmat ndërkombëtar nuk janë të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe as nuk i përgjigjen qytetarëve të pjesës veriore apo jugore të Mitrovicës, atëherë AUM-i, EULEX-i dhe ZCN-ja nuk duhet të kenë kompetenca apo autoritet vendimmarrës. Në nivelin komunal, as Qeveria e Serbisë nuk duhet të ketë ndonjë kompetencë. Mekanizmat e vetëm përgjegjës duhet të jenë të zgjedhur në mënyrë demokratike dhe t’i përgjigjen banorëve të pjesës veriore të Mitrovicës.

Pyetja që vlen 1 milion dollarë: Por a do të marrin pjesë serbët?

Është më se e qartë që procesi i zgjedhjeve demokratike është kyç për qeverisje të mirë dhe llogaridhënie. Megjithatë, shkalla e pjesëmarrjes së serbëve të Kosovës në zgjedhjet komunale mbetet e diskutueshme. Sipas hulumtimit të IKS-it, vetëm pesë përqind e banorëve të pjesës veriore të Mitrovicës planifikojnë të votojnë në zgjedhjet komunale të Kosovës në nëntor të vitit 2009.⁵



⁵ Hulumtimi i IKS-it në gusht të vitit 2009 përfshiu 100 respondentë të grupmoshës 18-65 nga pjesa veriore e Mitrovicës.

Siç shihet në grafikonin 2, arsyeja kryesore pse serbët nuk votuan ishte fakti që Qeveria e Kosovës i organizoi zgjedhjet (77 përqind); ata kurrë nuk votojnë në zgjedhje (18 përqind); dhe asnjë anëtar i familjes së tyre dhe asnjë mik nuk kanë planifikuar të votojnë (5 përqind). Asnjëri prej respondentëve që planifikuan të mos votojnë nuk tha që politikanët lokal apo Qeveria e Serbisë ju ka thënë mos të votojnë.

19 përqind e respondentëve që thanë se nuk e kanë ditur a do të votojnë a jo, zbuluan që vendimi i tyre për të votuar mund të ndikohet nga mendimi i tyre në ditën e zgjedhjeve (tetë respondentë), nga politikanët lokal (gjashtë respondentë), nga familja dhe miqtë (3 respondentë), dhe nga Qeveria e Serbisë (dy respondentë).

Pa udhëheqës të zgjedhur, serbët do ta kenë shumë vështirë të ndikojnë në vendimet që merren në komunën e tyre. Ndoshta është befasi fakti që në mesin e njerëzve ka shumë ndjenja të pafuqisë. Afro një e katërta e serbëve të anketuar nga IKS-i thonë që nuk kanë ndonjë ndikim mbi jetën e tyre. Vetëm 1.4 përqind e tyre besojnë që kanë shumë ndikim. Në pyetjen se si mund të ndikojnë në komunën e tyre, një grua u përgjigj, “Çka mund të bëjmë? Kjo komunë nuk ka veshë.”⁶ Përveç kësaj, 95 përqind e qytetarëve që jetojnë në veri shprehën ndjenjën e përjashtimit social.⁷

Këtë pranverë, serbët që jetojnë në veri të Mitrovicës do ta kenë një shans të dytë. Ata do të kenë rastin ta formësojnë vet të ardhmen e tyre duke marrë pjesë në zgjedhjet që parashihet të mbahen në maj të vitit 2010 në komunën e re të Mitrovicës së veriut. Këto zgjedhje do t’iu ofrojnë banorëve të veriut mundësinë për t’i zgjedhur përfaqësuesit e vet dhe për ta ndërtuar komunën e re ku ata përbëjnë popullatën shumicë. Pjesëmarrja e tyre në këto zgjedhje është kryesore në mënyrë që brengat e tyre të fillojnë të adresohen.

Kush është i kënaqur?


Autoritetet komunale, të paktën në teori, janë përgjegjëse për identifikimin dhe trajtimin e problemeve sociale dhe ekonomike të qytetarëve, nganjëherë në bashkëpunim me qeverinë qendrore dhe me agjencitë ndërkombëtare, e nganjëherë vetëm. Funkzioni themelor i çdo komune është ofrimi i shërbimeve bazike, përfshirë këtu arsimin, zhvillimin ekonomik, dhe infrastrukturën siç janë rrugët dhe shërbimet publike. Çështja vijuese atëherë është nëse zyrtarët e zgjedhur të Mitrovicës po i kryejnë detyrat dhe obligimet e tyre. Çfarë mendimi kanë banorët e Mitrovicës për kryerjen e këtyre funksioneve themelore?

⁶ Intervistë e IKS-it me një banor serb, 17 gusht 2009.

⁷ Afro 30 përqind “pajtohen plotësisht” dhe 65 përqind “pajtohen deri diku” me deklaratën: “Ndihej i përjashtuar nga shoqëria.” Nga të dhënat për Mitrovicën, UNDP, “Raporti i Paralajmërimit të Hershëm,” prill 2009.

Në pjesën veriore, 35 përqind e respondentëve të anketuar nga IKS-i u shprehën të pakënaqur me punën e komunës, 34 përqind nuk ishin as të kënaqur e as të pakënaqur, dhe 27 përqind ishin të kënaqur (shih grafikonin 3).⁸

Grafikoni 3. Kënaqësia e Qytetarëve me punën e autoriteteve lokale në veri të Mitrovicës



Sipas Programit Zhvillimor të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP), shumica e shqiptarëve në Mitrovicë duket se janë të kënaqur me punën e Kuvendit Komunal.⁹ Megjithatë, intervistat e IKS-it me banorët e pjesës jugore të Mitrovicës treguan dallim të qartë në mes të mendimeve të tyre rreth punës së autoriteteve komunale. Siç shpjegon një pronar i ri i një dyqani të pajisjeve për telekomunikim:

Nuk jam aspak i kënaqur. Gjendja me furnizimin me energji elektrike dhe me ujë është katastrofike. Unë e paguaj shërbimin për largimin e mbeturinave, por ata kurrë nuk vijnë. Problemi më i madh është që komuna nuk po bën asgjë për shtëpinë time në veri. Serbët jetojnë atje, prandaj unë duhet të paguaj qira për të jetuar në pjesën jugore. Që gjashtë vite, më kanë premtuar ndihma për ta paguar këtë qira, por nuk më kanë dhënë asgjë.¹⁰

Të rinjtë që jetojnë në pjesën jugore në përgjithësi shprehën të zhgënjyer. Shumë prej tyre mendojnë që qeveria komunale nuk ka arritur t'i adresoj brengat e tyre. Një vajzë në të 20-tat thotë:

E kënaqur? Asgjë nuk është në rregull në këtë qytet. Nuk jam aspak e kënaqur, dhe po tërë fajin e kanë politikanët. Ne duhet t'i detyrojmë ata që të pensionohen sepse gjenerata e vjetër nuk po i lë të rinjtë të marrin frymë. Është e natyrshme që të rinjtë nuk po pranojnë t'i bashkohen partive politike. Pse t'iu ndihmojnë

⁸ Hulumtim i IKS-it, Mitrovica Veriore, gusht 2009.

⁹ Nga të dhënat e veqanta për Mitrovicën, *Raporti i Paralajmërimit të Hershëm*, prill 2009.

¹⁰ Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 6 korrik 2009.

politikanëve që janë në pushtet? Unë do të filloj të votoj vetëm atëherë kur politikanët të fillojnë t'i dëgjojnë të rinjtë.¹¹

Të rinjtë tjerë që u përpoqën të futën në politikë shprehën frustrimin që mendimet e tyre nuk u morën fare parasysh. “Jemi munduar të organizojmë disa grupe politike me shkollën, por shumë shpejt hoqëm dorë sepse kur provuam të bisedojmë me politikanët ata u dukën shumë të paimteresuar.”¹² Një banor i ri nga pjesa veriore e Mitrovicës shprehi brenga të ngjashme: “Asnjë i ri nuk është i interesuar në politikë. Politikanët premtojnë vende të punës dhe shumë gjëra tjera, por asgjë nuk po ndodh. Në Beograd na marrin seriozisht por këtu... asnjëherë.”¹³

Mund të vërehet qartë dallimi në mes të gjeneratave kur bëhet fjalë për punën e udhëheqësve komunal. Pjesëtarët më të vjetër të popullatës shprehen të kënaqur me punën e politikanëve lokal. “Kryetari i komunës është njeri i mirë, ai është shumë i afërt me njerëzit. Ai po punon shumë, por nuk e ka lehtë. Ku do të kishim qenë pa këtë kryetar të komunës? As nuk duhet të mendojmë në këtë drejtim.”¹⁴

Një qytetar tjetër thotë që shumë çështje janë përtej pushtetit të komunës. “Jam i kënaqur me punën e komunës. Ata i kanë përmirësuar kushtet dhe shërbimet. Kryetari po përpiqet të bëjë më tepër, mirëpo nuk ka pushtet. Do të votoj në nëntor sepse shpresoj se një ditë gjërat do të bëhen më mirë.”¹⁵

Përgjegjës ... për çka?

Dallimi mund të vërehet edhe në mendimet e banorëve rreth asaj se ku duhet t'i përqendrojnë burimet autoritetet komunale. Në pjesën jugore, të rinjtë mendojnë që papunësia është prioritet. “Problemi kyç,” thotë një student 19-vjeçar, “është papunësia. Nëse kryetari i komunës premton vende të reja të punës, atëherë ai është përgjegjës për t'i gjetur ato. Jo të gjithë mendojnë që kjo çështje madhore, por sigurisht që është. Si mund të jetojnë të rinjtë pa punë?”¹⁶

Është e vërtetë që të rinjtë në Mitrovicë janë në rrezik më të madh nga varfëria e skajshme dhe papunësia sesa të rinjtë në pjesët tjera të Kosovës.¹⁷ Të rinjtë që kërkojnë punë i vuajnë pasojat e ekonomisë së shkatërruar dhe tregut jashtëzakonisht të vogël të punës,¹⁸ ku shumicën e vendeve të punës e kanë gjeneratat e vjetra. Një rrobaqepës 50-vjeçar në pjesën veriore të qytetit shpjegon, “Gjendja për të rinjtë këtu është tejet e keqe...

¹¹ Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar.

¹² Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 13 gusht 2009.

¹³ Intervistë e IKS-it me një banor serb, 17 gusht 2009.

¹⁴ Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 13 gusht 2009.

¹⁵ Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 6 korrik 2009.

¹⁶ Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 13 gusht 2009.

¹⁷ Banka Botërore, “Vlerësimi i Varfërisë,” 2006.

¹⁸ Për më tepër informata rreth ekonomisë, shih punimin e IKS-it, “Ekonomia në Mitrovicë,” 2009.

Shumë njerëz të moshuar punojnë në vende të punës për të cilët ata janë shumë të vjetër ... Prioriteti kryesor i komunës është të sigurohet që të rinjtë nuk do të largohen nga qyteti.”¹⁹ Edhe nëse të rinjtë gjejnë punë, ata zakonisht punësohen në sektore të cilat nuk përqendrohen në zhvillimin personal të punëtorëve. Një vajzë e re thotë, “Shumica e shoqeve të miya punojnë si kameriere... kjo është njëra prej punëve më të famshme në Mitrovicë. Ato të gjitha mundohen të largohen në Prishtinë, por është shumë vështirë.”²⁰

Ikja e të rinjve nga qyteti i Mitrovicës ishte temë e shpeshtë e bisedës gjatë intervistave që IKS zhvilloi me banorët e qytetit. Shumë pak të rinj mund të mbesin dhe të ndërtojnë të ardhme këtu. Megjithatë, duket se autoritetet komunale i kanë kushtuar tejet pak rëndësi kësaj çështjeje. Siç u pa edhe në citatat e lartpërmendura, udhëheqësit komunal duket se nuk janë shumë të gatshëm të takohen me të rinjtë dhe t’i trajtojnë brengat e tyre me seriozitet. Deri më tani, nuk dihet për asnjë hap të vetëm për trajtimin e punësimit të të rinjve në këtë qytet.

Në sytë e gjeneratave më të vjetra, problemi më akut është ndarja e Mitrovicës në pjesën veriore dhe atë jugore.²¹ Një banor 65-vjeçar i Mitrovicës thotë, “Problemi? Shiko përreth. Është tejet e qartë. Qyteti është i ndarë. Por sa mund të zgjas kjo? Ahtisaari tha se ky do të jetë qytet i bashkuar, por ne nuk mund të shkojmë në veri sepse atje nuk ka sundim të ligjit. Dikush duhet të ndër marr diçka.”²² Shumë qytetarë shprehen të brengosur për të ardhmen e qytetit dhe mendojnë që as komuna e as qeveria qendrore nuk po bëjnë sa duhet në këtë drejtim.

Banorët janë tejet të brengosur edhe për infrastrukturën e qytetit, posaçërisht për gjendjen e rrugëve. Një banor i ri komenton: “Rrugët janë në gjendje të tmerrshme; të gjithë mendojnë se mund të vozisin si në gara automobilistike. Në rrugë poashtu ka shumë plehra.”²³ Çështjet tjera të cilat i preokupojnë banorët e Mitrovicës janë: sundimi i ligjit, korrupsioni në mesin e zyrtarëve publik, ndërtime ilegale, nepotizmi, ndërprerjet e energjisë elektrike, reduktimet e ujit, dhe cilësia e dobët e arsimit.²⁴

Nga çrregullimi në rregull: kompetencat, karakteristikat e përbashkëta dhe komunikimi

Siç u pa nga konfuzioni në mesin e qytetarëve se “kush është në krye” të Mitrovicës dhe pohimi i disa respondentëve që disa çështje janë përtej të kontrollit të udhëheqësve komunal, njëra prej çështjeve më të rëndësishme është të qartësohet ngatërrimi i

¹⁹ Intervistë e IKS-it me një banor serb, 17 gusht 2009.

²⁰ Pjesëmarrës në fokus grupin e IKS, 17 korrik 2009.

²¹ Shumë qytetarë e dalluan këtë si çështje madhore për Rrjetin Kosovar të Gruas (“Voters’ Voice: The Issues Voters Demand Their Government Address,” Prishtinë, 2009. Mund të gjendet në: www.womensnetwork.org).

²² Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 13 gusht 2009.

²³ Intervistë e IKS-it me një banor serb, 17 gusht 2009.

²⁴ Rrjeti Kosovar i Gruas, “Voters’ Voice: The Issues Voters Demand Their Government Address,” Prishtinë, 2009, f. 25-26. Për arsim, shih raportin tjetër të IKS-it “Ekonomia në Mitrovicë,” 2009.

kompetencave. Kompetencat e mbetura në duart e autoriteteve ndërkombëtare (AUM, EULEX dhe ZCN) duhet t'i barten menjëherë autoriteteve lokale që zgjidhen nga banorët e Mitrovicës dhe që i përgjigjen këtyre të fundit. AUM-i duhet të hartoj një strategji të largimit në bashkëpunim të ngushtë me mekanizmat e tjerë relevant që veprojnë në pjesën veriore të Mitrovicës. Qeveria e Kosovës duhet ta bëjë auditimin e shpenzimeve për mirëmbajtjen e AUM-it deri sot në mënyrë që tatimpaguesit të kenë pasqyrë të qartë se si janë shpenzuar paratë e tyre.

Në këtë rrafsh, aspekti kyç do të jetë sigurimi që serbët do të marrin pjesë në zgjedhjet që do të mbahen në pranverë. Vendimmarrësit ndërkombëtar, udhëheqësit komunal, Qeveria e Kosovës, organizatat joqeveritare dhe grupet lokale duhet të bëjnë përpjekje për t'i inkurajuar serbët e Kosovës që të marrin pjesë në zgjedhjet e ardhshme komunale. Duhet të punohet në prezantimin e argumenteve bindëse që pjesëmarrja e serbëve në këto zgjedhje mund të çoj në zgjidhje për problemet dhe brengat e tyre. Duke marrë pjesë në zgjedhje, ata do të mund t'i zgjedhin udhëheqësit e tyre politik dhe të kërkojnë llogari prej atyre përfaqësuesve për trajtimin e brengave të tyre, duke e përdorur fuqinë e votës së tyre. Ata do ta kenë fuqinë e krijimit të komunës së tyre dhe do të mund të ndikojnë në proceset vendimmarrëse.

Në këtë aspekt, Bashkimi Evropian mund të luaj rol të veçantë. Derisa BE-ja punon drejt dukshmërisë më të madhe në pjesën veriore të Kosovës, hapi i ardhshëm strategjik mund të jetë themelimi i qendrës informuese në veriun e Mitrovicës. Kjo qendër mund të merret me aktivitete të komunikimit dhe të ofroj informata për t'i edukuar banorët e Mitrovicës, posaçërisht të rinjtë, për politikën e BE-së për Kosovën, rajonin, dhe më gjerë (p.sh., për politikën e tregtisë, migrimit, arsimit dhe kontrollin e cilësisë së produkteve). Mundësia e integritit të ardhshëm në Bashkimin Evropian është qëllim i përbashkët i serbëve dhe shqiptarëve. Kjo njëkohësisht është dritare për bashkëpunim të mundshëm në mes të shqiptarëve dhe serbëve në Mitrovicë.

EKONOMIA NË MITROVICË

Që nga përfundimi i luftës në vitin 1999, zhvillimi ekonomik i Kosovës ka ecur përpara me shpejtësi të kërmillit. Me shkallën më të lartë të papunësisë në Ballkanin Perëndimor (43 përqind), nuk është për t'u çuditur fakti që ekonomia e Kosovës mbetet larg vendeve të tjera të rajonit.²⁵ Megjithatë, me punë të zellshme, me vendimmarrje të fortë dhe me qeverisje të mirë, ka hapësirë për optimizëm rreth të ardhmes ekonomike të Kosovës. Shteti më i ri në botë ka potencial bujqësor, fuqi të re punëtore, burime të pasura natyrore si dhe potencial për turizëm. Shkalla e rritjes ekonomike në Kosovë u dyfishua nga viti 2007 në vitin 2008 (nga 2.8 përqind në më tepër se 5 përqind).²⁶ Edhe shkalla e papunësisë ka shënuar rënie nga 52.3 përqind në vitin 2003 në 43 përqind në vitin 2008.²⁷

Megjithatë, derisa qytetet si Prishtina, Prizreni dhe Ferizaji kanë filluar t'i gëzojnë frytet e rritjes ekonomike të Kosovës, ekziston rreziku real që Mitrovicës “do t'i ik treni.” Dikur zemra e zhvillimit ekonomik të Kosovës, sot ekonomia e kësaj komune ka stagnuar. Shkalla e papunësisë në Mitrovicë vlerësohet të jetë rreth 70 përqind.²⁸ Në vitin 1990 numri i njerëzve të punësuar në Mitrovicë ishte 11,467 krahasuar me Ferizaj, që ishte 8,643.²⁹ Komuna e Mitrovicës është përplot tensione sociale dhe politike. Qyteti i Mitrovicës, vazhdon të jetë i ndarë dhe statusi i tij politik ende nuk është zgjidhur. Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) ka theksuar “që nuk ka asnjë vend tjetër në Evropën Juglindore i cili vuan njëkohësisht nga tensionet e vazhdueshme etnike dhe pasojat e deindustrializmit, dhe në asnjë vend tjetër kombinimi i këtyre dy faktorëve nuk ka shkaktuar kriza aq të rënda sociale dhe ekonomike si në komunën e Mitrovicës.”³⁰

Në këtë analizë, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) argumenton që udhëtimi i rrezikshëm i Mitrovicës më tepër ka të bëjë me bazat e saj të lëkundshme ekonomike, me infrastrukturën e dobët, investimet e pamjaftueshme, frymën e dobët të afarizmit, menaxhimin joadekuat institucional, dhe lëvizshmërinë e kufizuar të mallrave dhe shërbimeve, e më pak me politikat ndëretnike. Edhe pse përmirësimi i gjendjes ekonomike në Mitrovicë do të varet pjesërisht nga zhvillimi i përgjithshëm ekonomik i Kosovës, IKS-i ka identifikuar disa fusha në të cilat mund të merren masa të vogla dhe afatshkurta për ta ngritur në këmbë ekonominë lokale.

²⁵ Komisioni Evropian, “Ballkani Perëndimor në Tranzicion,” Punime të Rastit 46, maj 2009.

²⁶ Shkalla e papunësisë në Kosovë akoma mbetet dukshëm më e lartë se ajo në Maqedoni (36 përqind), Mal të Zi (31 përqind), dhe në Bosnje e Hercegovinë (30 përqind) (Komisioni Evropian, “Ballkani Perëndimor në Tranzicion”).

²⁷ Të dhënat e Bankës Botërore për Kosovën.

²⁸ “Agjenda e Mitrovicës për Zhvillim Ekonomik Lokal,” Koordinuar nga UNMIK-u në Mitrovicë, 2004. Në vitin 2006 shkalla e pavarësisë në Mitrovicë është rritur në gati 70% përderisa mesatarja e përgjithshme është rritur vetëm 45%. Mitrovica përbën pjesën më të madhe të varfërisë se sa çdo regjion tjetër, duke përfshirë Prishtinën. Të gjitha të dhënat janë marrë nga Banka Botërore, Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë (2007).

²⁹ Radnici u Drustvenom Sektoru po Delatnosti, Stanje 30, septembra 1990.

³⁰ Iniciativa Evropiane për Stabilitet, “E Ardhmja Post-Industriale,” Prishtinë, 2004.

Baza të lëkundshme, e ardhme e paqëndrueshme

Sektori privat i cili është shfaqur që nga viti 1999 është kryesisht i shkallës së vogël dhe kërkon investime të vogla kapitale. Në vitin 2008 sektori privat përbënte 45 përqind³¹ të të hyrave (42.3 përqind në jug dhe vetëm 8 përqind në veri në vitin 2004.)³² Prej numrit të përgjithshëm të popullatës në pjesën jugore të qytetit (66,000), vetëm 12 përqind prej tyre janë të punësuar në sektorin privat. Rreth gjysma e bizneseve janë të angazhuara në tregti dhe shitje me pakicë.³³ Varësia e madhe nga tregtia ka rritur edhe më tepër deficitin tregtar të Kosovës.³⁴ Vëmendje tejet e vogël i është kushtuar zgjerimit të tregut, inovacioneve, apo zhvillimit të sektorëve të tjerë. Aktivitetet tjera të vetme në Mitrovicë janë ndërtimtaria, transporti dhe restorantet. Industria lokale ka mbetur e pazhvilluar.

Është më se e qartë që Mitrovica nuk ka zhvilluar “bazë të mjaftueshme ekonomike.”³⁵ Mjedisi aktual afarist ka dështuar në “gjenerimin e zhvillimit ekonomik”³⁶ meqë janë krijuar shumë pak vende të reja të punës. 95 përqind e bizneseve të regjistruara kanë më pak se pesë nëpunës, dhe shumica e bizneseve menaxhohen nga pronarët e tyre. Në përgjithësi, familjet vazhdojnë të luftojnë për mbijetesë.³⁷

Shitorja e vogël e Bekimit, e udhëhequr nga familja e tij, në rrugën kryesore të pjesës jugore të qytetit, është shembulli më ilustrativ i kësaj gjendjeje. Në raftet e shitores së tij janë të radhitura cigaret, ëmbëlsirat, biskotat dhe mallrat e ndryshme shtëpiake. Mirëpo, këto mallra nuk janë dëshmi e mirëqenies ekonomike të familjes së Bekimit. Ai thotë:

Çdo javë blej mallra nga një depo jashtë Mitrovicës, e cila furnizohet nga kamionët që vijnë nga Maqedonia, Greqia, Kroacia dhe Turqia. Kryesisht blej mallra bazike ... ato për të cilat kanë nevojë njerëzit. Shpjegimi më i mirë për punën time është blej dhe shit. Fitimi më mundëson ta vazhdoj këtë punë mirëpo ende jam i varfër.³⁸

Gjysma e bizneseve të regjistruara dhe rreth 20 përqind të njerëzve të punësuar në Mitrovicë janë të angazhuar në këtë lloj të tregtisë. Në aspektin strukturor, ka pasur

³¹ Të dhëna nga komuna e Mitrovicës, 2008.

³² Iniciativa Evropiane për Stabilitet, “E Ardhmja Post-Industriale,” Prishtinë, 2004.

³³ Të dhënat nga Komuna e Mitrovicës (2008) tregojnë që 3,500 banorë janë të angazhuar në tregti.

³⁴ Deficitin tregtar të Kosovës (vetëm mallrat) u rrit për 42.6 përqind të GDP-së në vitin 2007 dhe vazhdoi të rritej në vitin 2008 për shkak të bazës së vogël eksportuese të Kosovës.

³⁵ Të dhënat nga Komuna e Mitrovicës tregojnë që 606 njerëz punojnë në ndërtimtarë; 702 në transport; dhe 718 në hotele dhe restorante.

³⁶ Efekti i “gjenerimit të zhvillimit ekonomik” i referohet idesë neoliberalë që pasuria e ngritur nga kapitalizmi dhe tregjet e lira do të bie dhe do t’i arrij të varfrit, duke i nxjerrë kështu njerëzit nga varfëria. Prandaj politikat neoliberale përfshijnë lirimet tatimore apo beneficinet tjera për bizneset dhe individët e pasur me mendimin që kjo do të ketë ndikim të tërthortë për popullatën e gjerë dhe do të krijoj vende të punës.

³⁷ Sipas Zyrës për Punë Sociale në Komunën e Mitrovicës, 2,671 familje janë në “fazën e mbijetesës.”

³⁸ Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 3 korrik 2009.

shumë pak ndryshime që nga viti 1999. Sot thjesht ka më tepër kioska, shitore, kafene, sallone të floktarisë dhe taksistë.³⁹

Industria dikur e fuqishme përpunuese e qytetit është zhdukur pothuajse plotësisht. Vetëm 7 përqind e bizneseve janë të regjistruara formalisht si prodhuese. Në pjesën jugore të Mitrovicës, vetëm 1 përqind e popullsisë punon në prodhimtari.⁴⁰ Megjithatë, shumë njerëz mendojnë që e ardhmja qëndron në ringjalljen e të kaluarës: “Trepça⁴¹ është esenciale për të ardhmen tonë dhe ajo është e vetmja rrugë përpara,” thotë një banor.⁴²

Në vitin 1998, kompleksi xehetar i Trepçës kishte 22,885 punëtorë, dhe përfaqësonte 9 përqind të fuqisë punëtore të Kosovës. Në vitin 1989, vetëm në Mitrovicë ishin të punësuar 7,917 persona, përfshirë këtu 5,121 shqiptarë të Kosovës, 2,544 serbë të Kosovës, dhe 252 të tjerë. Në atë kohë, Trepça përfaqësonte punësimin më të madh të qytetit.⁴³ Pastaj në vitin 1989, regjimi serb i largoi mijëra minatorë shqiptarë nga puna. Në mes të viteve 1989-1991, fuqia punëtore e Trepçës u tkurr për 57 përqind (nga 13,261 në 5,720 punëtorë). Në vitin 1995, vetëm 1,200 nga 7,000 punëtorë të Trepçës ishin shqiptarë të Kosovës.⁴⁴

Sot, Trepça ka 2,525 punëtorë, përfshirë këtu 1,355 shqiptarë (54 përqind) dhe 1,170 serbë (46 përqind). Jo të gjithë mendojnë që rihapja e kompleksit të Trepçës do t’i zgjidh problemet e qytetit. Një banor në pjesën veriore shpreh pesimizmin e tij: “Mitrovica nuk mund të prodhojë më. Dikur e kemi pasur industrinë më të mirë në Ballkan. E tërë Jugosllavia shikonte drejt nesh, drejt Trepçës. Ky ishte qytet i prodhuesve të mëdhenj, por tash po i prodhojmë problemet më të mëdha.”⁴⁵

Për shumë arsye, rihapja e kompleksit të Trepçës nuk është qëllim realist afatshkurtër. Siç shpjegon edhe Grupi Ndërkombëtar i Krizave:

Problemet e Trepçës janë të shumta dhe komplekse. Ato përfshijnë borxhet e saj të pretenduara, çështjen e pronësisë së vërtetë dhe kush ka përfituar nga kjo, kushtet e përkeqësuar të makinerisë së vjetruar, fuqinë tejet të madhe punëtore, numrin e pamjaftueshëm të investitorëve të mundshëm, ndikimin

³⁹ Kuvendi Komunal i Mitrovicës, *Strategjia për Zhvillim Ekonomik Lokal 2009-2011*, Prishtinë, shtator 2008, f. 16. Numri i ekonomive familjare në Mitrovicë është 13,243. Numri i përafërt i popullsisë në pjesën jugore të Mitrovicës është 66,000 banorë. Numri i personave në moshë për punë (15-65) është 52,400. Numri i personave të punësuar zyrtarisht është 17,180 (përfshirë këtu punëtorët e Trepçës). Ekonomia gri me gjasë është më e madhe sesa sugjerohet në vlerësimet e Kuvendit Komunal të Mitrovicës. Sipas zyrtarëve komunal, rreth 200 njerëz janë të angazhuar në biznese të përgjithshme.

⁴⁰ Të dhëna nga Komuna e Mitrovicës tregojnë që vetëm 665 persona janë të përfshirë në prodhimtari.

⁴¹ Kompleksi i Trepçës, i cili gjendet afër qytetit të Mitrovicës, besohet që ka pasur deri në 23,000 punëtorë në kulmin e punës në vitet 1980.

⁴² Intervistë e IKS-it me një zyrtar komunal, 3 korrik 2009.

⁴³ Michael Palairat, “Trepça 1965-2000: A report to LLA/ESI,” 2003.

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ Intervistë e IKS-it me një banor serb, 1 korrik 2009.

jashtëzakonisht të keq mjedisor të shkrites së Zveçanit dhe politikën e brendshme në Kosovë.⁴⁶

Qeveria e Kosovës akoma duhet ta përgatis një studim serioz të fizibilitetit për ringjalljen ekonomike të Trepçës. E ardhmja e Trepçës mbetet e bllokuar nga kontestet ligjore rreth pronësisë, infrastrukturës së dëmtuar, mosefiçencës ekonomike, dhe kostove të larta për riaktivizim. Ndërmarrja ende nuk ka treguar profit që nga fillimi i viteve 1980 dhe ka borxhe të jashtëzakonshme.⁴⁷ Përveç kësaj, riparimi i dëmit mjedisor të shkaktuar nga dekadat e tëra të industrisë së rëndë do të jetë shumë i shtrenjtë. Pastrimi i kësaj zone mund të kushtoj deri në 100 milion euro, fakturë të cilën do të duhet ta mbulojnë ndërkombëtarët.⁴⁸

Varësia nga kuleta e qeverisë

Pa financime gjithëpërfshirëse publike, ekonomia në Mitrovicë do të shembej. Shumica e qytetarëve në Mitrovicë janë të punësuar në sektorin publik. Rreth 4,000 persona punojnë në shkolla, spitale, dhe në administratën publike në pjesën jugore të qytetit. Qeveria e Serbisë i përkrah edhe 4,100 nëpunës publik në pjesën veriore të qytetit. Numri i personave që marrin ndihma sociale nga shteti në pjesën jugore është pothuajse i njëjtë me numrin e të punësuarve; në vitin 2009, deri 11,752 persona merrnin ndihma sociale, duke arritur shumën totale prej €160,260 në muaj.⁴⁹ Në pjesën veriore të qytetit, në vitin 2008, transferet sociale dhe puna në ekonominë gri përbënin 60 përqind të të ardhurave totale të qytetarëve.⁵⁰

Qeveria e Serbisë shpenzoi më shumë se 169 milionë Euro në vitin 2008 në paga mujore vetëm për të punësuarit në Kosovë,⁵¹ edhe pse kriza ekonomike ka nënkuptuar që Serbia është dashur të reduktojë shpenzimet qeveritare në Shtesat e Kosovës përgjysmë në mes të vitit 2008 dhe 2009.

Niveli i lartë i varësisë nga burimet shtetërore mund të ketë pasoja serioze. Futja e të ardhurave shtesë nga Beogradi, që synonte të shërbente si qetësues, u tregua të jetë një formë e eutanazisë. Si rezultat i pagesave nga Beogradi, banorët e pjesës veriore të qytetit mendojnë që gjenden në një zonë komforti në të cilën janë harruar shprehitë e punës dhe dekurajohet rritja e sektorit privat.

⁴⁶ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, *Trepça: Zbërthimi i Labirintit*, Uashington dhe Prishtinë, 26 nëntor 1999.

⁴⁷ "Agjenda e Mitrovicës për Zhvillim Ekonomik Lokal," Koordinuar nga UNMIK-u në Mitrovicë, 2004.

⁴⁸ "Agjenda e Mitrovicës për Zhvillim Ekonomik Lokal," Koordinuar nga UNMIK-u në Mitrovicë, 2004.

⁴⁹ Zyra për Punë Sociale, Mitrovicë.

⁵⁰ Cituar në SPARK, "Vlerësimi i Potencialit për Zhvillim Ekonomik në Kosovën Veriore," 2008.

⁵¹ Transparency Serbia, "Gjurmimi i fondeve nga Serbia për në Kosovë-Metohi," Beograd, qershor 2009 (ende nuk është publikuar). Shuma totale e të hollave të paguara për paga mujore të punëtorëve në Kosovë dhe Metohi në vitin 2008 ishte 16.162.368.474 RSD or 169.882.655 Euro. IKS-i ka konvertuar këtë shumë në Euro, duke u bazuar në ratën e këmbimit të datës 10 dhjetor, 2009. Faqja e internetit për norma të këmbimit është: <http://www.xe.com/>.

Pasojat e varësisë mund të jenë të skajshme edhe në pjesën jugore të qytetit. Derisa ekonomia e dobët i kontribuon shpenzimeve të larta publike për skemat e ndihmave sociale,⁵² mbeten më pak para për infrastrukturë dhe për investime tjera që nevojiten për rritje ekonomike, duke e krijuar kështu një rreth vicioz. Për të qenë më joshës në aspektin ekonomik për investitorët potencial, qyteti duhet të shkëputet nga varësia dhe ta rris sektorin privat.

Tregu jofunksional i punës

Nëse Kosova është moçal i punësimit në rajon, atëherë Mitrovica është vrima e ujërave të zeza. Banka Botërore ka konkluduar që Mitrovica e ka shkallën më të lartë të papunësisë dhe shkallën më të ulët të punësimit në nivel kombëtar.⁵³ Niveli i papunësisë është 70 përqind. Pasojat e deindustrializimit janë të dukshme në tërë Kosovën,⁵⁴ por komplikimet e tyre nuk janë kuptuar plotësisht as nga komuniteti ndërkombëtar por as nga politikëbërësit lokal.

Tregu i stagnuar i punës ndikon në çdo pjesë të qytetit. Në pjesën jugore të qytetit, sipas statistikave komunale, që nga fillimi i vitit 2009 janë hapur 37 vende të punës përderisa 23,756 persona janë regjistruar si të interesuar për punë. Sipas këtij trendi, do të nevojiten 2,000 vite për ta përgjysmuar nivelin e papunësisë.⁵⁵ Një banor në pjesën jugore thotë:

Që gjashtë vite po kërkoj vend të duhur të punës por gjendja këtu është katastrofale. Është sikur të shpresosh që treni do të vij, por kur shikon në distancë nuk e sheh atë. Gjatë gjashtë viteve i kam gjetur vetëm dy vende potenciale të punës në qytet: t'i pastroj rrugët apo të punoj si kamerier. Nuk është për t'u çuditur që shumë njerëz kalojnë në krim. Përpara kam punuar si inxhinierë, dhe çdo ditë dal dhe kërkoj, por asgjë nuk ndryshon. Nuk ka asgjë të re. Gjendja e papunësisë është katastrofike dhe askund nuk ka vende të punës.⁵⁶

Ngjashëm me pjesën jugore, punësimi në pjesën veriore të qytetit tregon shumë pak shenja për ringjallje, dhe ka pesimizëm të thellë për mundësitë e reja. Të dhënat hulumtuese të UNDP-së tregojnë që shumica dërrmuese e serbëve në Mitrovicë besojnë që gjendja aktuale e punësimit është e pafavorshme dhe se kjo gjendje do të vazhdojë edhe në gjashtë muajt e ardhshëm,⁵⁷ një banor në veri ankohe:

⁵² Numri total i personave që marrin ndihma sociale: 11,782.

⁵³ Banka Botërore, "Vlerësimi i Varfërisë në Kosovë," 2007.

⁵⁴ Shih p.sh LLA/ESI, Deindustrializimi dhe shpërbërja e pronës shoqërore – Një rast studimi i Pejës, Prishtinës dhe Berlinit, shkurt 2002; LLA/ESI, Qeverisja komunale dhe zhvillimi ekonomik – Mësimet e mësuara nga dhe për Kosovën; Raste studime Gjilani dhe Vitia, Kosovës.

⁵⁵ Vlerësim i IKS-it bazuar në statistikat komunale.

⁵⁶ Intervistë e IKS-it me një banor shqiptar, 3 korrik 2009.

⁵⁷ Të dhënat specifike për Mitrovicën nga UNDP, "Raporti i Paralajmërimit të Hershëm," prill 2009.

Vende të punës këtu? Nuk ka gjasa. Unë e kam diplomën e inxhinierit të diplomuar por çka mund të bëjë? Vetëm shikojini kioskat e zbrazëta në rrugë. A po ju duket thujse ka shumë biznese? Nuk e di madje pse e kanë hapur universitetin këtu kur nuk ka vende të punës.⁵⁸

Përveç kësaj, shumë respondentë thonë që vendet e pakta të punës janë ndarë në bazë të nepotizmit e jo në bazë të meritave. “Kënd e njeh” më parë se “çka din” ishte faktor përcaktues për gjetjen e vendit të punës. Një pjesëmarrës në njërën prej fokus grupeve të IKS-it thotë:

Vëllai im jeton në pjesën veriore të Mitrovicës dhe është arsimuar për 26 vite por nuk mund të gjen vend të punës sepse nuk i ka lidhjet e duhura. Ai është ekspert i telekomunikimit. Pasi ka kërkuar shumë herë vend të punës, ka kërkuar takim me drejtorin e PTK-së por ai nuk e ka pranuar kërkesën e tij. Vëllai im dhe familja e tij jetojnë në varfëri në pjesën veriore të qytetit. Një ditë shkova në postë dhe vajza e cila punonte aty nuk dinte as ta lexonte faturën. Ajo sigurisht nuk e ka mbaruar as shkollën e mesme. Gjendja e tyre po më plak para kohës dhe e tërë kjo ndodh sepse ai nuk ka lidhje të korruptuara.⁵⁹

Çka mund të bëhet për promovimin e rritjes ekonomike në Mitrovicë? Së pari, banorët e Mitrovicës duhet të kenë mentalitet të ri. Përzierja e rrezikshme e deindustrializmit, politikës dhe tensioneve etnike nuk duhet ta pengoj ndërtimin e bazave të reja ekonomike. Shikuar nga këndvështrimi ekonomik, në Mitrovicë nuk janë “dy realitete” por më shumë një qytet i bashkuar rreth rrezikut serioz. Pjesa veriore dhe ajo jugore e qytetit ballafaqohen me sfidat e *njëjta* ekonomike, dhe ato kanë kërkesa të *ngjashme* për ringjalljen e ekonomive të tyre.⁶⁰ Për ta integruar qytetin në ekonominë e Kosovës duhet të ndërmerren veprime të menjëhershme, urgjente dhe të përbashkëta.

Vazhdimi i perceptimit të qytetit si “i ndarë” do të ketë pasoja katastrofike për ekonominë. Zona natyrale ekonomike e Mitrovicës e përfshin tërë qytetin. Politikanët lokal duhet të nxjerrin mësim nga fati i qyteteve të ndara gjatë Luftës së Ftohtë, kur entitetet e natyrshme ekonomike në mbarë Gjermaninë u ndan përgjysmë. Qytezat dhe fshatrat përgjatë vijës ndarëse Lindje-Perëndim përjetuan vdekje të ngadalshme ekonomike për shkak se zona e tyre natyrshme ekonomike u tkurr dhe nuk i kishin më në dispozicion mjetet e përbashkëta ekonomike. Shenjat “Mbyllur” e varura në dyert e bizneseve në rrugën Mbretëresha Teuta janë dëshmi e problemeve të tregut të tkurrur dhe e dobësisë së qytetit ndaj ndarjes së vazhdueshme. Tregu i tkurrur do të vazhdoj të ndikoj në rritjen ekonomike të të *dy* pjesëve të qytetit.

⁵⁸ Intervistë e IKS-it me një banor serb, 17 gusht 2009.

⁵⁹ Pjesëmarrës në fokus grupin e IKS, 17 korrik 2009.

⁶⁰ Pjesa veriore e Mitrovicës ballafaqohet me sfida shtesë të sundimit të ligjit për shkak të mungesës së qartësisë rreth përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së qeverisë atje.

Ekonomia bazike thotë që nëse nuk ka lëvizshmëri të mallrave dhe shërbimeve, çdo fushë ekonomike do të kaloj momente shumë të vështira. Për të zhvilluar tregti brenda qytetit, banorët e pjesës veriore duhet të regjistrohen tek autoritetet komunale, t'i blejnë dy lloje të regjistrimeve, dhe ndoshta të ballafaqohen me tërbimin e bashkëqytetarëve të tyre. Varësia e tyre e përbashkët ndaj shkëmbimit të mallrave dhe shërbimeve është arsye e mjaftueshme për t'u ballafaquar me këto sfida. Aktiviteti i ngjeshur në Mëhallën Boshnjake është dëshmi e potencialit të tregut të zgjeruar.

Banorët e Mitrovicës nuk mund ta nxjerrin vet qytetin nga izolimi ekonomik; zhvillimi i qytetit varet nga integrimi i tij i plotë në tregun kombëtar dhe në tregjet rajonale. Duhet të gjinden stimulime financiare për ta inkurajuar bashkëpunimin në mes të gjitha grupeve etnike në veri dhe në jug. “Zona e Liruar nga Dogana”⁶¹ mund ta stimulojë lëvizshmërinë e tregut, por ka shumë pak dëshmi të kërkesave. Shumë afaristë në Mitrovicë i bashkëngjiten frustrimit të z. Idrizi, i cili është pronar i një dyqani për shtyp në pjesën jugore të Mitrovicës:

E ndërtova këtë dyqan në vitin 2002. Për shumë vite kam sakrifikuar dhe kam punuar shumë në mënyrë që biznesi të jetë i suksesshëm. Nganjëherë makinat e shtypit prishen. Njerëzit e vetëm që dinë t'i rregullojnë ato janë serbët në pjesën veriore të qytetit dhe nuk kam asnjë problem me ta... Ne jemi kolegë të mirë, por kurrë nuk e di a do të vijmë sepse disa njerëz në veri thonë që ata nuk mund të vijmë. Kjo është shumë frustruese dhe i dëmton të dyja palët... inxhinierët humbin, dhe unë i humb klientët dhe reputacionin tim.⁶²

Stimulimet financiare dhe stimulimet e tjera të bashkëpunimit duhet të shoqërohen edhe me sundimin efikas të ligjit. Derisa gjendja e sigurisë të jetë e brishtë, në Mitrovicë do të ketë shumë pak investime. Sundimi i ligjit dhe zhvillimi ekonomik shkojnë njëra krahas tjetrës. Të dyja nevojiten për të shtruar bazat e prosperitetit, stabilitetit, dhe për kthimin e sigurt të personave të zhvendosur.

Drejt rritjes ekonomike

Bazat e dobëta ekonomike të Mitrovicës duhet të adresohen urgjentisht. Përmirësimi i blloqeve kyçe të ekonomisë do të tregojë nëse aktiviteti minimal aktual ekonomik është shenja e fundit e një qyteti në vdekje apo shenja e parë e rigjenerimit të gjatë.

⁶¹ Rekomandim në KIPRED, “Vështrimi Përtej Urës së Mitrovicës, një pako zgjidhje Ahtisaari Plus,” Prishtinë: tetor 2008. Mund të gjendet në: <http://www.kipred.net>.

⁶² Fokus grupi i IKS, 17 korrik 2009.

Banorët e Mitrovicës e kanë të qartë nivelin e urgjencës: vetëm 32 përqind e shqiptarëve në Mitrovicë mendojnë që kushtet për afarizëm janë të favorshme, dhe një përqindje e ngjashme mendon që gjendja do të mbetet e njëjtë në gjashtë muajt e ardhshëm.⁶³ Derisa shumica e bizneseve janë të destinuar të luftojnë apo dështojnë, çfarë incentivash kanë qytetarët për të ndërmarrë rikçe ekonomike? Një banor komenton:

Ta hap biznesin tim? Në asnjë mënyrë! Këtu nuk mund të fitosh para. Vetëm mund të humbasësh para. Nëse gjërat do të kishin qenë më të qëndrueshme dhe solide, atëherë do të kisha menduar për këtë. Shqiptarët kanë shpirt biznesi, dhe ne dimë të jemi të përkushtuar dhe të organizuar, mirëpo të ndërtojmë një biznes të suksesshëm këtu është si të provosh të mbjellësh bostan në shkretëtirë.⁶⁴

Rritja ekonomike kërkon investime financiare, mirëpo banorët e Mitrovicës thjesht nuk kanë qasje në kapital fillestar. Edhe nëse arrijnë të sigurojnë ndonjë kredi, kushtet janë për periudha afatshkurtra, nevojiten garanci të shumta, dhe normat e interesit janë zakonisht më të larta sesa kreditë e konsumatorëve për individë që punojnë në sektorin public.⁶⁵ “Është si në Perëndim të Egër... Bankat nuk mund të financojnë aktivitete për ringjallje ekonomike për shkak të rreziqeve,”⁶⁶ shpjegon një bankier në pjesën veriore të Mitrovicës.

Ngjashëm me këtë, 80 përqind e serbëve që jetojnë në Mitrovicë mendojnë që kushtet aktuale për afarizëm janë të pafavorshme.⁶⁷ Ky pesimizëm është i arsyeshëm kur dihet fakti që për çdo biznes që hapet në pjesën veriore dy të tjerë mbyllen.⁶⁸ “Kjo është vrimë e zezë për investime,” thotë një banor.

E ardhmja ekonomike e Mitrovicës varet nga ndërmarrësia. Në pjesën jugore të qytetit, ka shembuj të përkrahjes së suksesshme për ndërmarrësit. Biznesi i z. Idrizi është dëshmi e kësaj, por këto përpjekje duhet të zgjerohen më tutje. Në pjesën veriore të qytetit, mungon fryma e ndërmarrësisë. Një studim rishtazi ka treguar që mungesa e arsimit praktik, joshja nga subvencionet publike, statusi i paqartë politik, institucionet e dobëta, sundimi i mangët i ligjit, dhe “shiriti i kuqi” i kontribuojnë mungesës së ndërmarrësisë.⁶⁹

Struktura e papërshtatshme në Mitrovicë është një çështje tjetër e cila duhet të adresohet urgjentisht: gjendja e dobët e rrugëve, transporti joefikas publik, dhe ç’është më e rëndësishmja, furnizimi i pamjaftueshëm me ujë dhe energji elektrike janë disa ndër problemet e shumta me të cilat ballafaqohet qyteti i Mitrovicës. Një studim i bërë nga

⁶³ Studimi i bërë nga IKS në gusht të vitit 2009 përfshiu 100 respondentë të grupmoshës 18-65 nga pjesa veriore e Mitrovicës.

⁶⁴ Intervista e IKS me një banor shqiptar, 3 korrik 2009.

⁶⁵ Intervista e IKS me një banor serb, 1 korrik 2009.

⁶⁶ Intervista e IKS me një banor serb, 17 gusht 2009.

⁶⁷ Të dhënat specifike për Mitrovicën nga UNDP, “Raporti i Paralajmërimit të Hershëm,” prill 2009.

⁶⁸ Vlerësimi i IKS-it i nxjerr nga të dhënat specifike për Mitrovicën nga UNDP, “Raporti i Paralajmërimit të Hershëm,” prill 2009.

⁶⁹ Cituar në SPARK, “Vlerësimi i Potencialit për Zhvillim Ekonomik në Kosovën Veriore,” 2008.

UNMIK-u në vitin 2004 zbuloi që shumica e ndërmarrjeve operojnë në “nivele të mbijetesës” dhe janë shumë të ndjeshme ndaj luhatjeve të tregut. Më tepër se 30 përqind e ndërmarrjeve të vogla operojnë në mjedis të hapur; 38.5 përqind nuk kanë energji elektrike; dhe 46.2 përqind nuk kanë furnizim me ujë.⁷⁰ Duket se shumë pak gjëra kanë ndryshuar prej vitit 2004 prej kur është bërë studimi i UNMIK-ut. Si rezultat i kësaj, prodhimtaria efikase është e vështirë dhe investitorët potencial i kanë drejtuar sytë tjetërkund. Për këtë arsye, zhvillimi i infrastrukturës së Mitrovicës duhet të jetë prioritet. Agjencioni Zhvillimor Rajonal për Mitrovicën duhet të ndajë burime domethënëse për përmirësimin e infrastrukturës në këtë zonë.

Përveç kësaj, edhe qeverisja e dobët e dëmton ekonominë. Fondet që qeveria e Serbisë i ka dhënë për pjesën veriore të Mitrovicës nuk janë investuar në mënyrë të mençur. “Fondet vinin nga Serbia por ato investoheshin në ndërmarrje që kanë ndikim politik e jo në ndërmarrje fitimprurëse. Këto ishin biznese artificiale,” thotë një afarist lokal në pjesën veriore të qytetit.⁷¹

Edhe në pjesën jugore të qytetit vërehet fenomeni i keqmenaxhimit. “Arsyeja kryesore pse ende e kemi këtë gjendje janë zyrtarët lokal dhe ata qendror,”⁷² thotë një pjesëmarrës në njërën nga fokus grupet e IKS-it. Një afarist tjetër ankohet për keqtrajtim nga doganat lokale.⁷³ Disa afaristë në pjesën jugore të Mitrovicës besojnë që qeveria i ka ndarë parcelat për parkun lokal të afarizmit duke u bazuar në nepotizëm e jo në gjykim racional.⁷⁴

Konkludim

Problemet më domethënëse që e pengojnë integrimin dhe zhvillimin ekonomik të Mitrovicës janë industria tejet e dobësuar e xehetarisë, infrastruktura e dobët, tregtia e dobët për shkak të tregut të cunguar, varësia e madhe nga shpenzimet publike, tregu jofunksional i punës, mentaliteti i fiksuar në të kaluarën e lavdishme, dhe kushtet e pafavorshme për afarizëm. Përveç kësaj, mungesa e sundimit të ligjit dhe fakti që qyteti mbetet i ndarë prej dhjetë vitesh i kanë keqësuar edhe më tej problemet ekonomike. Si pjesë e përpjekjeve për t’i zgjidhur disa prej këtyre çështjeve, disa masa afatshkurtra mund të ndikojnë në ringjalljen ekonomike.

KIPRED, institut vendor për kërkime me seli në Prishtinë, ka propozuar krijimin e “zonës së veçantë të investimeve” e cila do ta mbulonte territorin e pjesëve jugore dhe veriore të Mitrovicës dhe Zveçanin, të cilat dikur përbënin një komunë të vetme, duke formuar

⁷⁰ Cituar në Inicativën Evropiane për Stabilitet, “E Ardhmja Post-Industriale,” 2004.

⁷¹ Intervistë e IKS-it me një banor serb, 17 gusht 2009.

⁷² Fokus grupi i IKS-it, 21 korrik 2009.

⁷³ Po aty.

⁷⁴ Po aty.

kështu një zonë të natyrshme ekonomike.⁷⁵ Në këtë “zonë të veçantë të investimeve,” ndërmarrjet do të liroheshin nga taksat komunale (p.sh. për licencim, pronë, etj) dhe nga tatimet mbi fitim në nivelin qendror. Ato do të vazhdonin të paguanin tatimet e tjera, siç është tatimi mbi të hyrat, kontributet e punës, tatimi i të hyrave të punës, dhe Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) për mallra dhe shërbime. Përveç “zonës së veçantë të investimeve” do të mund të themelohej edhe “zona e liruar nga dogana” në rajonin midis pjesës jugore të Mitrovicës, pjesës veriore të Mitrovicës dhe Zveçanit, ku ndërmarrjet do të liroheshin nga taksat e korporatave dhe përfitimit dhe taksat doganore për mallrat e importuara siç janë pajisjet.⁷⁶

Subvencionet bujqësore për bujqit vendor poashtu do të mund ta zhvillonin ekonominë në këtë zonë kryesisht rurale. Edhe pse fuqia punëtore bujqësore e Mitrovicës (32,363) është më e vogël se ajo e Prishtinës (37,083) apo e Pejës (49,149), ajo megjithatë është mjaft e madhe.⁷⁷ Bujqit që nuk mund të garojnë me produkte relativisht të lira në rajon, mund të ndihmohen me subvencione, çmime të garantuara minimale, dhe lirim nga tatimet mbi mallrat e nevojshme siç janë farat dhe benzina.

Duhet të adresohen edhe standardet ligjore dhe ato cilësore në mënyrë që prodhuesit të mund t'i shesin produktet e tyre në tregjet evropiane dhe të ofrojnë produkte të cilësisë së lartë.⁷⁸ Bujqësia mund të kontribuoj shumë në zhvillimin ekonomik, posaçërisht në pylltari, pulari dhe blegtori. Prodhuesit kanë nevojë për përkrahje në mënyrë që të kalojnë nga bujqësia e subvencionuar dhe të shesin së paku në tregje të vogla lokale e ndoshta edhe më gjerë.

Një fushë tjetër e cila mund ta përmirësoj punësimin dhe zhvillimin ekonomik është turizmi malor. Malet e Shalës së Bajgorës janë vend ideal për rritjen e bizneseve të vogla familjare. Në vitin 2006, Programi për Grante të Vogla (SGP) i “Global Environment Facility” dhe Bashkëpunimi Teknik Gjerman (GTZ), dhuruan fonde për shtatë ekonomi familjare në fshatin e Thethit në Alpet veriore të Shqipërisë me synim të përmirësimit të kapaciteteve të tyre për turizëm.⁷⁹ Tri vite më vonë, investimi prej €14,000 ka rezultuar në €100,000 në shpenzime të turistëve,⁸⁰ duke joshur turistë nga e mbarë Evropa. Sipas

⁷⁵ Për më tepër hollësi, shih KIPRED, “Vështrimi Përtej Urës së Mitrovicës, një pako zgjidhje Ahtisaari Plus.”

⁷⁶ *Po aty.*

⁷⁷ Enti Statistikor i Kosovës, “Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2007. Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Ambientit,” korrik 2009. Mund të gjendet në:

http://www.ks-gov.net/esk/index.php?option=com_docman&task=cat_view&gid=9&Itemid=120.

⁷⁸ Shih punimin e IKS-it “The Rahovec-Brussels Express” (2009) rreth asaj se çka duhet të bëjnë institucionet kosovare për t'i përbushur standardet cilësore të BE-së dhe për ta përmirësuar prodhimtarinë bujqësore. Mund të gjendet në: <http://www.iksweb.org>.

⁷⁹ UNDP Shqipëri, “Lulëzimi i turizmit në Theth,” 24 shtator 2006. Mund të gjendet në:

<http://www.undp.org/al/index.php?page=detail&id=29>.

⁸⁰ *Reuters Life!* “Malet e largëta të Shqipërisë tash i joshin turistët,” 14 gusht 2009. Mund të gjendet në:

<http://www.reuters.com/article/idUSTRE57D2QG20090814>.

Entit Statistikor të Kosovës (ESK), gjysma e ekonomive familjare rurale në rajonin e Mitrovicës (14,248) posedojnë toka pyjore.⁸¹

Duke iu prezantuar donatorëve dhe investitorëve potencial një plan konkret për turizmin rural dhe malor, qeveria komunale dhe ajo qendrore mund t'iu ndihmojnë shumë familjeve në Mitrovicë që të krijojnë biznese të vogla e të qëndrueshme. Kjo do ta ulte shkallën e papunësisë dhe varfërinë dhe në të njëjtën kohë do ta zhvillonte një fushë tjetër e cila ka potencial të madh ekonomik: turizmin.

Në bashkëpunim me Bankën Qendrore të Kosovës dhe me sektorin bankar, qeveria mund të bëhet ndërmjetëse në mes bankave dhe qytetarëve për të ofruar kushte më të mira të kredive dhe norma më të vogla të interesit për bizneset. Agjencioni Rajonal Zhvillimor duhet të punoj me institucionet ndërkombëtare financiare për të krijuar një fond të ri për mikro-financa me kushte më të mira të kredive. Disa programe të mikro-financimit në vendet e tjera të botës kanë pasur efekt në zhvillimin e ekonomive vendore dhe në nxjerrjen nga varfëria të grupeve të varfra, posaçërisht të femrave.

Ndërhyrjet e politikave duhet të përqendrohen edhe në zhvillimin e ndërmarrësve. Programet e “Ekonomive të bazuara në Kompetenca nëpërmjet Ndërtimit të Ndërmarrjeve” (CEFE) janë treguar të suksesshme në rajonet e tjera të Kosovës,⁸² prandaj ato duhet të zgjerohen edhe në Mitrovicë, duke u mbështetur në praktikat e mira të SPARKS.⁸³ Kjo duhet të bëhet në kombinim me ringjalljen e ndërmarrjeve shoqërore dhe shtetërore në pjesën veriore të qytetit.

⁸¹ Enti Statistikor i Kosovës nuk ofron të dhëna vetëm për ekonomitë familjare që posedojnë toka pyjore në komunën e Mitrovicës. Në mbarë Kosovën, 41 përqind e ekonomive familjare rurale posedojnë toka pyjore. Bazuar në të dhënat për Kosovë dhe Mitrovicë, rreth gjysma e ekonomive familjare rurale në komunën e Mitrovicës poashtu posedojnë toka pyjore (SOK, “Anketa e Ekonomive Shtëpiake Bujqësore 2007. Seria 2: Statistikat e Bujqësisë dhe Ambientit,” korrik 2009. Mund të gjendet në: http://www.ks.gov.net/esk/index.php?option=com_docman&task=cat_view&gid=9&Itemid=120.

⁸² Shih <http://www.cefe.net/>.

⁸³ SPARK zhvillon arsimin dhe ndërmarrësinë në mënyrë që të fuqizohen të rinjtë dhe njerëzit ambicioz për ta udhëhequr shoqërinë e tyre të pasluftës drejt prosperitetit. Për më tepër shih: www.spark-online.org.

ARSIMI NË MITROVICË

Është 10:30 paradite e së premtes. Rrugët e Mitrovicës janë të mbushura me grupe të zhurmshme nxënësish shkollor të gjithë të nisur drejt një vendi, i njohur nga banoret e Mitrovicës si ‘kej.’ Me sa duket, përsëri kanë pasur orë të shkurtra mësimi. *Kej* është vendtakimi i nxënësve shqiptarë pas shkollës. Gjendet pranë Urës së lumit Ibër dhe shtrihet përgjatë anës jugore të tij. Përballë *kej*-it, në anën tjetër të bregut të Ibrit qëndrojnë nxënësit serbë. Ndryshe nga atmosfera e gjallërishme dhe e zhurmshme në të dy brigjet e Ibrit, ura qëndron e vetmuar me pak kalimtarë. Për një dekadë të tërë, kjo urë ka ndarë qytetin dhe rininë e tij në vija etnike. Edhe sikur këta të rinj të kalonin urën, vështirë se do të gjenin një gjuhë të përbashkët sepse njohin vetëm të tyren.

Qyteti i ndarë i Mitrovicës padyshim që nuk pasqyron imazhin e paraparë për një shoqëri kosovare shumëetnike. Marrëdhëniet ndër-etnike në qytet vazhdojnë të jenë të brishta. Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet komunitetit serb dhe institucioneve të Kosovës çiftëzohet me sistemin e arsimit paralel serb për të krijuar sfida të reja.⁸⁴ Njerëzit në veri të Mitrovicës duken të kënaqur nga strukturat paralele serbe. Bashkëpunimi me institucionet e Kosovës duket i vështirë në një të ardhme të afërt me kushtet aktuale. Prej vitit 1999, sistemi arsimor në Mitrovicën veriore ka qenë i imunizuar ndaj ndryshimeve që kanë ndodhur në gjithë Kosovën.

Shkollat në jug të Mitrovicës janë nën autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës. Nxënësit shqiptarë vijojnë mësimin sipas planprogramit të Kosovës pa orë mësimi në gjuhën serbe. Shkollat në veri i pergjigjen Ministrisë së arsimit në Beograd. Kështu, nxënësit serbë të Kosovës arsimohen sipas planprogramit të Serbisë dhe nuk kanë orë mësimi të gjuhës shqipe.⁸⁵

Sistemet aktualisht të ndara arsimore në një mënyrë janë rrjedhojë e trashëgimisë së dekadave të diskriminimit dhe mospërfilljes. Në vitin 1989 Serbia hoqi autonominë e Kosovës, duke shfuqizuar legjislacionin e Kosovës mbi arsimin dhe autonominë e saj për sa i përket vendimeve mbi planprogramin. Prej vitit 1991 e tutje, arsimi në shkollat fillore vazhdoi në kushte diskriminuese dhe ndarje të rreptë. U ngritën mure ndërmjet nxënësve shqiptarë dhe serbë dhe mësimi zhvillohej me turne për ti mbajtur të ndarë.⁸⁶

Sistemi u ashpërsua edhe më tej për arsimin e mesëm. Për 36,000 fëmijët shqiptarë që përfunduan shkollat fillore në vitin 1991, vetëm 6,000 vende u vunë në dispozicion në

⁸⁴ Komisioni Evropian, *Dokument Indikativ për Planifikim Shumëvjeçar (DSHIP) 2007-2009 për Kosovën nën Rezolutën e KS të OKB 1224*, qershor 2006.

⁸⁵ OSBE, *Komunitetet Joshumicë të Kosovës brenda Sistemeve të Shkollimit Fillor dhe të Mesëm*, prill 2009.

⁸⁶ Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), me mbështetje të UNICEF-it, *Drejt Lisbonës: Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale si dhe i krijimit të mundësive për punësim të femrave në zonat rurale*, Prishtinë, janar 2008.

shkollat e mesme.⁸⁷ Një pjesë e madhe e arsimit në gjuhën shqipe u organizua “fshehtas” në shtëpi private, hangare dhe garazhe. Ky sistem funksiononte si sistem “paralel” i vetëfinancuar përkrah sistemit serb deri në vitin 1998. Shpërthimi i luftës ndërpreu mësimin deri në shtator të vitit 1999.

Një dekadë pas luftës, Kosova ende ka sisteme paralele arsimore. Tani, Republika e Serbisë mbështet sistemin paralel arsimor të qytetarëve serbë të Kosovës përmes financimit, planprogramit dhe pajisjeve shkollore.⁸⁸ Sistemi paralel serb i arsimit në veri të Mitrovicës ofron arsim fillor, të mesëm dhe të lartë në gjuhën serbe. Veç kësaj, ai ofron disa lëndë në gjuhën rome për komunitetin rom që jeton në jug të Mitrovicës. Në një mënyrë, sistemi i fragmentuar arsimor mishëron sfidat me të cilat përballen autoritetet e Kosovës në ndërtimin e një shtetit shumetnik.

Ndarja fizike e serbëve dhe shqiptarëve në sisteme të ndara arsimore ka thelluar ndarjet ekzistuese ndërmjet komuniteteve etnike. Për afro një dekadë, ndarja e qytetit ka lënë fëmijët serbë dhe shqiptarë të Mitrovicës pa qasje në shkollat që gjenden në anët e kundërta të qytetit. Mungesa e infrastrukturës shkollore është bërë përpjestuesi i përbashkët i komuniteteve të ndara të qytetit.

Nevojë e dëshpëruar për hapësirë

Sot, Mitrovica ka 38 shkolla fillore ku ofrohet mësim për 16,962 nxënës. Shkolla e mesme teknike, shkolla e mesme ekonomike, shkolla e mesme e mjekësisë, si dhe gjimnazi funksionojnë në të dy pjesët e qytetit. Shkolla fillore e muzikës gjendet në jug. Gjithsej 7,107 nxënës janë regjistruar në shkollat e mesme për vitin 2009.

	Shkolla fillore	Nxënës në shkolla fillore	Shkolla të mesme	Nxënës në shkolla të mesme	Gjithësej
Mitrovica jug	27	14,012	5	5,017	19,029
Mitrovica veri	11	2,950	4	2,090	5,040
Gjithësej	38	16,962	9	7,107	24,069

Burimi: Drejtoria e Arsimit, Komuna e Mitrovicës dhe Departamenti i Arsimit i UAM-së

Sfida kryesore e Mitrovicës në lidhje me arsimin është nevoja për më shumë hapësira shkollore dhe pajisje. 24,069 nxënës në këtë komunë vijnë në mësimin kryesisht në dy ndërrime ndërsa disa shkolla punojnë me tri ndërrime. Në të dy pjesët e qytetit shkolla të ndryshme duhet të ndajnë një ndërtesë. Aktualisht, sipas Drejtorisë së Arsimit të

⁸⁷ Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), *Shqyrtim tematik i politikave shtetërore për arsimin – Kosovë*, qershor 2001.

⁸⁸ Intervistë e IKS-it me qytetarë serbë, Mitrovicë e veriut, shtator 2009.

Kuvendit Komunal të Mitrovicës “shtatë shkolla në jug të Mitrovicës jugore zhvillojnë mësim vetëm në tri ndërtesa, gjë që rezulton në orë të shkurtuara për nxënësit.”⁸⁹

Shkolla e mjekësisë “Xheladin Deda” gjendet në jug të Mitrovicës dhe ka 841 nxënës që studiojnë si teknikë dentare, teknikë farmacie, infermierë, pediatër, dhe asistentë të përgjithshëm mjekësorë. Drejtori i shkollës, Aslan Istrefi, është i sigurt për suksesin e nxënësve të tij. “Për katër vite me radhë ata kanë arritur rezultatet më të mira në testin shtetëror të Kosovës.”⁹⁰ Kjo shkollë ka ndërruar lokacionin gjashtë herë në dhjetë vitet e fundit, nxënësit ndjekin njërin nga tri ndërrimet çdo ditë, si dhe ora e mësimit zgjat vetëm 35 minuta. Duke pasur parasysh kushtet në të cilat funksionon kjo shkollë, ose duhet përgëzuar shkolla për suksesin e saj në këto kushte të pamundura, ose të ndjehemi jashtëzakonisht të dëshpëruar me cilësinë e dobët të sistemit edukativ të Kosovës.

Shkolla fillore “Muharrem Bekteshi,” e vendosur përgjatë bregut jugor të lumit Ibër, ka të njëjtin fat. Shkolla ka 749 nxënës të grupmoshës 9-15 vjeçe por objekti ku ajo ndodhet është i mbipopulluar me nxënës nga shkolla fillore “Nonda Bulka” dhe aktualisht punon me dy ndërrime.⁹¹ Për një dekadë, shkolla e mjekësisë “Xheladin Deda,” shkolla e mesme teknike “Arkitekt Sinani,” shkolla fillore “Nonda Bulka,” si dhe shkolla fillore “Aziz Sulejmani” kanë pasur një itinerar endacak, duke ndërruar lokacionet pothuajse çdo vit.⁹²

Infrastruktura shkollore është e dobët edhe në pjesën veriore të qytetit. Shkolla fillore “Branko Radicevic” aktualisht akomodon pesë shkolla të tjera fillore, të zhvendosura në pjesën veriore të qytetit pas konfliktit.⁹³ Gjimnazi dhe shkolla e mesme ekonomike janë zhvendosur në veri dhe aktualisht janë të vendosura në ndërtesën e shkollës së mesme teknike, në të cilën janë gjithashtu të vendosura dhe dy shkolla të mesme të tjera si dhe fakulteti i Drejtësisë, dhe ai i Shkencave Natyrore dhe Matematikës. Këto shkolla punojnë me dy turne.⁹⁴ Predrag Stojcetovic, drejtor i Departamentit Rajonal të Mitrovicës për Arsimit, në veri të Mitrovicës komentoi:

Shumica e shkollave janë evakuuar nga vendndodhja e mëpërparshme dhe janë vendosur në objektet e shkollave të tjera, duke sjellë me vete më shumë nxënës dhe më shumë staf. Tani problemi qëndron tek gjetja e një lokacioni për këto shkolla dhe vendosja e nxënësve.⁹⁵

⁸⁹ Kuvendi Komunal i Mitrovicës, Drejtoria e Arsimit, *Plani zhvillimor 2009-2011*, janar 2009.

⁹⁰ Ky është provimi përfundimtar të cilin duhet t’iu nënshtrohen të rriturit e rinj në fund të shkollimit të tyre të mesëm.

⁹¹ Intervistë e IKS-it me Sanie Raifi, drejtoreshë e shkollës fillore “Muharrem Bekteshi”, jugu i Mitrovicës, qershor 2009.

⁹² Intervistë e IKS-it me Aslan Istrefi, drejtor i shkollës së mesme të mjekësisë “Xheladin Deda”, jugu i Mitrovicës, korrik 2009.

⁹³ Ato janë, O.S. “Veljko Banasevic”; O.S. “Svetozar Markovic”; O.S. “Vlada Cetkovic”; O.S. “Desanka Maksimovic”; O.S. “Braca Mihajlovic.”

⁹⁴ Intervistë e IKS-it me Goran Saveljic, mësues në veri të Mitrovicës, nëntor 2009.

⁹⁵ Intervistë e IKS-it me Predrag Stojcetovic, drejtor i Departamentit Rajonal të Mitrovicës për Arsimit, në veri të Mitrovicës, shtator 2009.

Drejtorët e katër shkollave në pjesën veriore të qytetit kanë kërkuar nga administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë që t'i ndihmojë ata në ndërtimin e një shkolle të përbashkët për gjimnazin dhe shkollën e mesme ekonomike.⁹⁶ Sipas Goran Saveljic, mësues në veri të Mitrovicës, 'ata asnjëherë nuk kanë marrë përgjigje.'⁹⁷ Shkollat fillore dhe të mesme në veri të lumit Ibër përballen me probleme të ngjashme me shkollat fillore dhe të mesme në jug, ndonëse në një masë më të vogël për shkak të numrit relativisht më të vogël të nxënësve në veri.

Prej vitit 2005, ka pasur një rritje prej 37 për qind në numrin e nxënësve të shkollave të mesme.⁹⁸ Duke patur parasysh ritmin e ngadaltë të ndërtimit të shkollave të reja në Mitrovicë, kjo rritje në numrin e nxënësve do ta çojë infrastrukturën shkollore në prag të thyerjes. Mungesa e hapësirës ka nxitur probleme të tjera që ndikojnë në cilësinë e arsimit në këto shkolla të stërmbushura. Mungesa e pajisjeve dhe orët e shkurtuara të mësimit, 35 minuta në vend të normales 45, e rëndojnë edhe më tej situatën.

Për shkak të numrit të madh të nxënësve në secilën shkollë në jug të Mitrovicës, shumë laboratorë shfrytëzohen si klasa. Ata pak laboratorë ekzistues janë shumë të varfër për sa i përket pajisjeve. Ferdane Merovci për më shumë se njëzet vite shpjegon fizikë në gjimnazin "Frank Bardhi." "Frank Bardhi" është i tejmbushur me 1,996 nxënës. Për të krijuar më shumë hapësirë për të gjithë, drejtorja e shkollës vendosi që t'i shndërrojë disa laboratorë në klasa mësimi. Për Znj. Merovci kushtet në të cilat zhvillohet mësimi lë shumë për të dëshiruar:

Është e pamundur të shpjegosh mësime në këto kushte. Deri tani reformat nuk kanë sjellë asgjë të re. Asgjë nuk ka ndryshuar për sa i përket lëndës sime, madje as librat shkollore. Nxënësit e mi nuk kanë laborator për të praktikuar ato që mësojnë. Unë mundohem ta kompensoj këtë me eksperimente të thjeshta, por kjo nuk mjafton.⁹⁹

Ndonëse reformat mbarë-kosovare të sistemit të arsimit kërkojnë që mësime të bëhen t'i organizojnë nxënësit në grupe të vogla, ky synim nuk mund të arrihet në klasa mësimi me dyzet nxënës në një orë mësimi prej 35 minutash. Reformat në arsim pengohen gjithashtu dhe nga fanatizmi i profesorëve të vjetër për metodat e vjetra të mësimeve. Pavarësisht dhjetëra trajnimeve që këta profesorë kanë ndjekur gjatë viteve të fundit, ata vazhdojnë të japin mësime sipas metodave të vjetra.¹⁰⁰

⁹⁶ Projekt-propozim i dorëzuar te Administrata e UNMIK-ut në Mitrovicë nga drejtorët e Gjimnazit, shkolla e mesme ekonomike dhe dy shkollat e mesme teknike, 2008.

⁹⁷ Intervistë e IKS-it me Goran Saveljic, mësues në veri të Mitrovicës, nëntor 2009.

⁹⁸ Kuvendi Komunal i Mitrovicës, Drejtorja e Arsimit, nëntor 2009.

⁹⁹ Intervistë e IKS-it me Ferdane Merovci, mësuese në Gjimnazin "Frank Bardhi", jugu i Mitrovicës, korrik 2009.

¹⁰⁰ Intervistë e IKS-it me Fazli Hajrizi, drejtor i Gjimnazit "Frank Bardhi", jugu i Mitrovicës, korrik 2009.

Arsimi serb në veri përballet me të njëjtat sfida pavarësisht nga ndryshimi i gjuhës dhe i planprogramit. Predrag Stojcetovic, drejtor i Departamentit Rajonal të Mitrovicës për Arsime theksoi:

Ndonëse planprogrami shkollor është rregulluar sipas ligjeve dhe strukturave të Ministrisë së Arsimit në Beograd, cilësia nuk është e njëjtë me atë të Serbisë. Ne kemi cilësi më të dobët për shkak të infrastrukturës shkollore.¹⁰¹

Nëse shqiptarët dhe serbët kanë vështirësi me cilësinë e arsimit, mësimi në gjuhë të tjera është gati i pamundur. Sistemi arsimor i Kosovës në Mitrovicë siguron planprogram për shkollimin fillor në boshnjakisht, turqisht dhe shqip. Shkollimi i mesëm është i mundur vetëm në boshnjakisht dhe shqip. Në të katër shkollat e mesme në jug të Mitrovicës, nga 5,017 nxënës gjithsej në vitin 2009, vetëm 37 (0.73 për qind) janë nxënës të pakicave joserbe. Ndonëse një numër i konsiderueshëm i komunitetit rom dhe ashkali jeton në jug të Mitrovicës, aktualisht vetëm gjashtë nxënës ashkali vijojnë shkollimin e mesëm: tre janë të regjistruar në gjimnazin “Frank Bardhi” dhe tre në shkollën e mesme teknike “Arkitekt Sinani.” Po ashtu, në shkollat e mesme në jug të Mitrovicës janë të regjistruar njëzet nxënës boshnjakë, dhjetë turq dhe një goran.¹⁰²

Sistemi paralel arsimor serb në veri të Mitrovicës ofron shkollim fillor dhe të mesëm në gjuhën serbe, si dhe disa orë mësimi në gjuhën romë. Ministra serbe e arsimit siguron tekste shkollore pa pagesë për nxënësit romë të klasës së parë. Megjithatë, nxënësit romë në veri të Mitrovicës kanë numër të kufizuar të teksteve shkollore, prandaj ata mund t’i shfrytëzojnë librat vetëm gjatë orëve të mësimi në shkollë dhe nuk mund t’i marrin librat në shtëpi. Barrierat gjuhësore me të cilat përballen komunitetet etnike joserbe në veri dhe komunitetet joshqiptare në jug i shtohen shportës së sfidave për të siguruar një shkollim të qasshëm dhe universal për të gjithë banorët e Mitrovicës.

Dy dekada ‘injustice’

Sistemi i ndarë arsimor ka krijuar një vakum komunikimi dhe nuk ka lënë hapësirë për terren të përbashkët dhe dialog ndërmjet mësuesve shqiptarë dhe serbë të Kosovës. Fëmijët kosovarë të lindur në vitin 2000 tanimë janë nëntë vjeç, vijojnë klasën e tretë apo të katërt të shkollës fillore. Ata nuk kanë fare kujtesë të konfliktit etnik. Megjithatë, ata nuk janë përjashtim i pasojave të tij. Segregimi gjithnjë në rritje i komuniteteve shqiptare dhe serbe krijon një situatë ku të rinjtë serbë dhe shqiptarë nuk kanë asnjë marrëdhënie me njëri tjetrin. Kur pyetëm për bashkëmoshatarët e tyre në veri të Mitrovicës, të rinjtë shqiptarë të ulur në kafenetë në jug të Mitrovicës mbledhin supet:

¹⁰¹ Intervistë e IKS-it me Predrag Stojcetovic, Drejtor i Departamentit Rajonal të Mitrovicës për Arsime, veri i Mitrovicës, shtator 2009.

¹⁰² Verena Knaus, *Dokument këshillëdhënës/Studim vlerësimi socio-politik për Kolegjin Evropian të Studimeve të Biznesit dhe Administratës Publike në Mitrovicë, përgatitur për SPARK* (nuk është për publikim), korrik 2009.

Unë kurrë nuk mendoj për jetën në pjesën veriore të Mitrovicës. Më duket si e ndaluar të mendoj për veriun. Nuk kam fare ide se si është jeta atje. Gjithçka që di e kam dëgjuar prej lajmeve.¹⁰³

Iniciativat për ti mbledhur studentët së bashku kanë ecur shumë pak. “Shkolla e rokut e Mitrovicës,” iniciativë e Zhvillimi i Komunitetit në Mitrovicë (CBM), ka hapur dyert e saj në tetor 2008. Filozofia prapa kësaj initiative qëndron në premisën që muzika është universale. Ajo synon të bashkojë grupe të ndryshme etnike në atë që e duan dhe që e kanë të përbashkët: muzikën rok. Me vendndodhje si në veri ashtu dhe në jug të Mitrovicës, kjo shkollë ka 32 dhe 35 nxënës të regjistruar, përkatësisht. Janë organizuar turne dhe koncerte jashtë Kosovës për nxënësit dhe grupet e saj. Megjithatë, kjo shkollë ka ndikim të kufizuar në jetën e përditshme të nxënësve të saj, siç theksoi një nxënës: “ndonëse synimi ishte ndërtimi i një shkolle shumëetnike të rokut në Mitrovicë, ne e shohim njëri-tjetrin vetëm kur jemi jashtë Kosovës dhe nuk takohemi kurrë në Mitrovicë.”¹⁰⁴

Drejt një qyteti universitar

Pavarësisht nga sfidat që hasen, përmirësimi i edukimit në Mitrovicë nuk është i pamundur. Mitrovica ka një sektor të madh universitar, si dhe ka potencial që të bëhet qendër e shkëlqimit të arsimit të lartë në Ballkanin Perëndimor nëse sfidat aktuale adresohen si duhet.

Fakulteti i shkencave teknike aplikative, me seli në jug të Mitrovicës, regjistroi 572 studentë për vitin akademik 2009/2010, që paraqet gjysmën e numrit të studentëve të regjistruar në vitin 1991.¹⁰⁵ Nga katër katedra, 133 studentë janë të regjistruar në Industrinë e Xeheve, 119 në Gjeologji, 271 në Teknologji dhe vetëm 49 në Metalurgji. Këto katër disiplina janë relikë e industrisë tradicionale të rajonit, që pësoi rënie vite më parë. Sipas Izet Zeqirit, Dekan i Fakultetit, ‘nuk ka më studentë që vijnë nga Presheva apo Maqedonia.’¹⁰⁶ Arsye për këtë është mungesa e konvikteve, të cilat gjenden në pjesën veriore të qytetit, në të cilat ata nuk kanë qasje.

Ndryshe nga sektori i vogël i arsimit të lartë në jug të Mitrovicës, rreth 9000 studentë janë të regjistruar në shkollimin universitar në pjesën e vogël veriore të qytetit. Universiteti i Mitrovicës, i zhvendosur në veri të Mitrovicës në fund të vitit 2001, tërheq shumicën e të diplomuarve serbë të shkollimit të mesëm, si dhe studentë serb nga Mali i Zi, Bosnja dhe Serbia.

¹⁰³ Grupi i Fokusit i IKS-it me studentë të Shkollës së Rokut, jugu i Mitrovicës, korrik 2009.

¹⁰⁴ Grupi i Fokusit i IKS-it me studentë të Shkollës së Rokut, jugu i Mitrovicës, korrik 2009.

¹⁰⁵ Fakulteti i Shkencave Teknike Aplikative në Mitrovicë, Universiteti i Prishtinës, nëntor 2009.

¹⁰⁶ Intervistë e IKS-it me Izet Zeqiri, Dekan i Fakultetit të Shkencave Teknike Aplikative, Universiteti i Prishtinës, jugu i Mitrovicës, nëntor 2009.

Ky universitet ofron drejtime në dhjetë disiplina duke përfshirë Filozofinë, Shkencat Teknike, Shkencat Natyrore dhe Matematikë, Mjekësi, Drejtësi, Ekonomi, Pedagogji, Edukim Fizik dhe Sporte, Art dhe Bujqësi. Studentëve nga zonat me shumicë serbe në Kosovë u sigurohet akomodim dhe shkollim pa pagesë.¹⁰⁷ Nga gjithsej 8924 studentë, 4573 janë studentë të financuar nga buxheti dhe 4351 paguajnë një pjesë të shpenzimeve vetë.¹⁰⁸

Infrastruktura e dobët duket të ketë lënë mbrapa sektorin e arsimit të lartë të Mitrovicës. Një student në Fakultetin e Pedagogjisë në degën e Filozofisë theksoi:

Fakulteti jonë nuk është i pajisur mirë, ekziston një laborator kompjuterik dhe shumica e kompjuterëve janë mjaft të vjetër. Nuk ka libra apo materiale shkollore të dobishme për Fakultetin tonë në bibliotekë. Klasat janë vetëm pjesërisht të pajisura. Projektorët janë të ri por profesorët tanë nuk janë trajnuar për t'i përdorur. Ne nuk jemi fare të përgatitur për tregun e punës. Unë jam në vit të fundit dhe ende nuk di si të shkruaj një raport shkollor. Ne nuk kemi asnje lloj këshillimi. Profesorët nuk vijnë në kohë [dhe] nuk sigurojnë materiale për mësim.¹⁰⁹

Krahasuar me Fakultetin e Pedagogjisë, Fakulteti i Gazetarisë duket t'i ketë punët më mirë. Ai zotëron klasë tërësisht të pajisura, bibliotekë të re, ligjërata dinamike, klasa të vogla, seminare me reporterë ndërkombëtarë televizivë, si dhe ligjërues mysafirë ndërkombëtarë. Fakulteti i Gazetarisë është i vetmi i cili nuk financohet nga Beogradi, por nga pagesat e studentëve. Përkundër cilësisë më të mirë të arsimit të ofruar, studentët nuk kanë të ardhme të sigurt, siç shpjegoi një student:

Pagesat e regjistrimit të vitit janë rreth €500, plus provimet, librat dhe kostot e tjera të jetesës. Unë mendoj se është kjo një shumë e madhe e parave duke pasur parasysh situatën aktuale të Kosovës. Është një nga arsyet që një numër i kufizuar i studentëve vendos të studiojë gazetarinë. Veç kësaj, është shumë e vështirë të gesh punë pas diplomimit, meqë ekzistojnë shumë pak radiostacione dhe televizione në veri të Kosovës dhe vendet e punës tanimë janë të zëna.¹¹⁰

Shqetësimi më i madh i rinisë në veri është mundësia e punësimit dhe Mitrovica veriore nuk e ofron atë. Kur i marrin parasysh mundësitë e tyre të punësimit në të ardhmen, është vështirë për ta që ta shikojnë anën tjetër të lumit Ibër. Të arsimuar në një mjedis tërësisht

¹⁰⁷ Grupi i Krizave Ndërkombëtare (ICG), *Integrimi i serbëve në Kosovë: Taking the Plunge*, Raport i Evropës nr. 200, maj 2009, f. 17.

¹⁰⁸ Transparency Serbia, "Gjurmimi i rrjedhës së financimit nga Serbia në Kosovë-Metohi," Beograd, qershor 2009 (ende i papublikuar).

¹⁰⁹ Intervistë e IKS-it me një student të degës së Pedagogjisë, Fakulteti i Filozofisë, Universiteti i Mitrovicës, shtator 2009.

¹¹⁰ Intervistë e IKS-it me një student të degës së Gazetarisë, Fakultetit të filozofisë, Universiteti i Mitrovicës, shtator 2009.

serb, në të cilin nuk e mësojnë gjuhën shqipe, të diplomuarit e rinj në veri të Mitrovicës kanë perspektivë të ulët të qëndrimit dhe ndërtimit të jetëve të tyre në Kosovë.¹¹¹

Siç theksuan banorët për IKS-in:

Nxënësit nuk janë as tejet të interesuar e as tejet mospërfillës ndaj shkollimit. Ndoshta... ata e dinë se pasi të përfundojnë shkollën do ta kenë të vështirë të gjejnë punë, madje disa herë të pamundur.¹¹²

Nxënësit e shkollës së mesme nuk e marrin mësimin e tyre seriozisht. Ata mendojnë se mësimi është i padobishëm meqë ata nuk mund të gjejnë punë.¹¹³

Kosova në përgjithësi dhe Mitrovica në veçanti duhet ta orientojnë sistemin arsimor drejt nevojave dhe kërkesave të sotme dhe të nesërme të tregut të punës. Cilësia e arsimit është sfidë të cilën qytetarët dhe qeveria e Kosovës duhet ta adresojnë më mirë shpejt sesa vonë. Arsimi i dobët rëndon problemet e papunësisë së rinisë. Gjatë pesë viteve të ardhme 200,000 njerëz do ta kenë arritur moshën e punësimit dhe do të hyjnë në tregun e punës. Duke parë nivelet e larta të papunësisë së rinisë, arsimi është prioritet kyç për Kosovën.¹¹⁴

Arsimit i është dhënë përparësi si një nga “katër E-të” thelbësore për zhvillimin e Kosovës (Ekonomia, Energjia, Edukimi dhe Evropa).¹¹⁵ Si i tillë, sektori i arsimit është bombarduar me një tepricë dokumentesh dhe planesh strategjike për zhvillimin e shkollimit të lartë, shkollimit parauniversitar, shkollimit profesional, integrimin të pakicave, arsimit dhe trajnimit të ndërmarrësisë, arsimit për të rritur, si dhe, më së fundi, një “kornizë gjithëpërfshirëse strategjike për mësim gjatë gjithë jetës” në vend të dokumenteve të fragmentuar strategjike. Fatkeqësisht, këto strategji të shumta me aktivitetet e tyre të planifikuara deri tani kanë qenë një “vrimë në ujë,” të cilave u mungonte zbatimi.

Sot, kosovarët janë më pak të arsimuar sesa bashkëmoshatarët e tyre evropianë dhe në këtë mënyrë më pak të përgatitur për të konkurruar për vende pune në tregun Evropian.¹¹⁶ Kosova ka një proporcion regjistrimesh në shkollë të ulët në krahasim me standardet rajonale, veçanërisht për sa i përket shkollimit të mesëm dhe të lartë. Numri i braktisjes së shkollës është i lartë. Një nga çdo dy të rinj braktisin shkollën para së t’i mbushin 18 vjet. Dy nga tre braktisin sistemin shkollor pa asnjë kualifikim. Regjistrimi në shkollat e

¹¹¹ Grupi Ndërkombëtar i Krizave (ICG), *Integrimi i serbëve në Kosovë: Taking the Plunge*, Raport i Evropës nr. 200, maj 2009, f. 18.

¹¹² Intervistë e IKS-it me Ferdane Merovci, mësuese e fizikës në gjimnazin “Frank Bardhi”, jugu i Mitrovicës, korrik 2009.

¹¹³ Intervistë e IKS-it me qytetarë serbë, veri i Mitrovicës, shtator 2009.

¹¹⁴ Komisioni Evropian (EC), *Kosova-Përmbushja e Perspektivës së saj Evropiane*, Bruksel, tetor 2009.

¹¹⁵ Katër sektorët prioritar për Kosovën sipas Qeverisë së Kosovës (të mëhershme dhe aktuale) janë Ekonomia, Energjia, Arsimit dhe Evropa, apo “4 E-të.”

¹¹⁶ Gerald Knaus, *Braktisja e Pushimeve Verore: Synim i Madh real për Kosovën*, Rumeli Observer, dhjetor 2008.

www.rumeliobserver.eu.

mesëm për vajzat është ndër më të ulëtit në Evropë.¹¹⁷ Tridhjetë e katër për qind të të rinjve braktisin shkollën për arsye ekonomike.¹¹⁸

Sistemet e arsimit dhe trajnimit aktualisht nuk janë në gjendje t'i adresojnë sfidat e punësimit me të cilat përballet popullata në moshë pune. Nëse situata në Kosovë tingëllon e zymtë, në Mitrovicë është edhe më e keqe. Sipas Bankës Botërore, rinia e Mitrovicës ka rrezikshmëri më të lartë të të qenit në varfëri të skajshme dhe e papunë sesa rinia që jeton në vende të tjera të Kosovës.¹¹⁹ Mitrovica është duke prodhuar rini të “dekurajuar” e cila është ngurruese dhe e papërgatitur për t’iu qasur tregut të punës, pavarësisht nëse adresa e tyre është në jug apo veri të lumit Ibër.

Konkludim

“Unë e shoh të ardhmen më të ndritshme. Unë jam optimiste, por ka shumë punë për t’u bërë.”

- Fjolla, studente në Mitrovicë

Mitrovica nuk ka mungesë të ideve mbi ndryshimin e realiteteve në vend. Ideja për themelimin e Kolegjit Evropian për Studime të Biznesit dhe Administratës Publike në Mitrovicë është prezantuar në Konferencën e përbashkët të Inicativës Evropiane për Stabilitet – Wilton Park në vitin 2004. Kolegji Evropian ka për synim transformimin e Mitrovicës në një qytet universitar shumetnik dhe në qendër shkëlqesie në shkollimin e lartë.

Mitrovica tanimë është drejt të qenit qytet universitar. Për momentin Universiteti i Mitrovicës është një faktor shumë i rëndësishëm i të ardhurave në veri të Mitrovicës. Një universitet i orientuar drejt nevojave dhe kërkesave të tregut të punës mund jetë pasuri për qytetin e Mitrovicës në shumë aspekte. Ky universitet do të kishte ndikim të konsiderueshëm në ekonominë lokale, duke krijuar vende pune në qytet dhe duke zgjeruar veçanërisht industrinë e shërbimeve lokale. Duke e hapur universitetin në të dyja anët dhe me lëndë mësimi në gjuhë të huaja, do të mund të ngrihej një terren i përbashkët për studentët si në veri ashtu dhe në jug. Përmes ofrimit të një shkollimi cilësor profesional dyvjeçar pas atij të mesëm, në Biznes dhe Administratë Publike, Kolegji Evropian i Mitrovicës do të pajiste një gjeneratë të re të afaristëve dhe politikëbërësve me aftësitë dhe njohurinë e nevojshme që do ta ndihmonin vendin në përgatitjen për integrimin e ardhshëm në BE.¹²⁰

¹¹⁷ Lida Kita, *HDR Country Analysis Kosovo*, dokument pune i Fondacionit Evropian për Trajnime (FET), maj 2008.

¹¹⁸ Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), me mbështetje të UNICEF-it, *Drejt Lisbonës: Vlerësimi i nevojave për trajnime profesionale si dhe i krijimit të mundësive për punësim të femrave në zonat rurale*, Prishtinë, janar 2008.

¹¹⁹ Banka Botërore (BB), *Rinia e Kosovës në rrezik: Të qenit i ri, i papunë dhe i varfër në Kosovë*, Raporti nr. 43596-XK, shtator 2008.

¹²⁰ Verena Knaus, *Dokument këshillëdhënës/Studim vlerësimi socio-politik për Kolegjin Evropian të Studimeve të Biznesit dhe Administratës Publike në Mitrovicë*, përgatitur për SPARK (nuk është për publikim).

Në kontekstin kompleks historik, politik dhe social të Kosovës, arsimi konsiderohet si faktor kryesor në ndërtimin e një shoqërie shumetnike dhe paqësore. Shpresat se arsimi do të zvogëlojë varfërinë, promovojë rritjen ekonomike dhe do të lehtësojë Integrimin Evropian janë të larta. Mitrovica ka nevojë për politika të shëndosha në mënyrë që t'i përmbushë këto kërkesa. Për të ndryshuar realitetet në terren, institucionet e Kosovës duhet të mbështeten tek dëshira dhe vullneti i komunitetit lokal. Ndoshta, përfshirja e të dyja gjuhëve në planprogram si lëndë e detyrueshme mund të jetë një fillim i mirë.

SHËNDETËSIA NË MITROVICË

Ndonëse shëndetësia është thelbësore për mirëqenien e qytetarëve, në Kosovë ajo vazhdon të jetë e gjymtuar nga problemet e infrastrukturës bazike, financiare dhe politike. Qeveria e Kosovës shpenzon rreth tre për qind të Bruto Prodhimit Vendor (BPV) dhe vetëm 10 për qind të shpenzimeve të përgjithshme qeveritare në sistemin e shëndetësisë.¹²¹ Ministria e Shëndetësisë (MSH), e cila është përgjegjëse për krijimin e politikave shëndetësore, ka zhvilluar strategjinë për periudhën 2005–2014. Megjithatë, nuk është zhvilluar asnjë plan i veprimit për zbatimin e saj, prandaj edhe është arritur progres i vogël në këtë drejtim.

Në vend të kësaj, Ministria ka filluar me zhvillimin e një strategjie të re për periudhën 2010-2014 e cila do të zbatohet duke filluar nga viti i ardhshëm. Pa vëmendje të duhur në aspektet teknike të zbatimit të saj, posaçërisht në krijimin e resurseve adekuate, ajo me gjasë do të përballet me të njëjtin fat sikur paraardhëset e saj. Ekspertët kanë shprehur shqetësimin se më shumë vëmendje i kushtohet hartimit të vazhdueshëm të strategjive të reja sesa zbatimit të tyre. Siç thekson Skender Sylja, Kryesues i Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSh) në Kosovë, “Në Kosovë, kur hartohet një strategji, ajo shihet si përfundimi i punës, por strategjia është vetëm hapi i parë ... Ministrinë vrapojnë që ta publikojnë [strategjinë] duke ftuar media, por nuk ndërmerren veprime të mëtutjeshme.”¹²²

Si pasqyrohet ky mosefikasitet në sektorin shëndetësor të Mitrovicës? Kujdesi shëndetësor në Mitrovicë përballet me sfida të mëtutjeshme për shkak të kompleksitetit politik. Në të kaluarën, kujdesi shëndetësor ofrohej nga spitali i Mitrovicës i cili gjendej në pjesën veriore të qytetit. Banorët e Mitrovicës ishin të mendimit që ky spital është konkurrent me spitalet tjera të Kosovës dhe më gjerë.

Megjithatë, ndarja e qytetit në vitin 1999 la qytetarët e jugut të Mitrovicës pa qasje në shërbime cilësore të shëndetësisë sekondare.¹²³ Meqë spitali gjendej në pjesën veriore të lumit Ibër, ata më nuk kishin kujdes shëndetësor sekondar në afërsi. Që atëherë, spitali i shërbente kryesisht komunitetit serb që jetonte në veriun e Mitrovicës.

Duke pasur parasysh kontekstin e veçantë politik, mund të mendohet se Qeveria e Kosovës do të duhet të kishte qasje të veçantë në ofrimin e shërbimeve të kujdesit

¹²¹ Banka Botërore, “Kosovë: Studim mbi reformat në financimin e shëndetësisë,” 6 maj, 2008.

¹²² Intervistë e IKS-it me Skender Sylën, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Udhëheqës i zyrës së OBSh-së, Prishtinë, 13 gusht, 2009.

¹²³ Në sistemin e kujdesit shëndetësor primar, komunat janë përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të shëndetësisë primare. Shërbimet e Kujdesit shëndetësor primar (KSHP) ofrohen nga më shumë se 30 Shtëpi të shëndetit (tani quhen Qendra për mjekësi familjare) dhe ambulanca shëndetësore. Ministria e Shëndetësisë është përgjegjëse për shërbimet e kujdesit shëndetësor sekondar. Shërbimet e shëndetësisë sekondare ofrohen nga spitalet. Shërbimi shëndetësor terciar përfshin shërbimet e specializuara të ofruara në Institucionet e Kujdesit Shëndetësor të autorizuara nga Ministria e Shëndetësisë, siç janë Qendra e Klinikave Universitare të Kosovës (QKUK).

shëndetësor në Mitrovicë. Megjithatë, sipas Flakron Sylejmanit, Këshilltar politik i Ministrisë së shëndetësisë, Mitrovica është trajtuar në të njëjtën mënyrë sikurse pjesët tjera të Kosovës.

Kjo analizë e politikave paraqet një pasqyrë të sistemit shëndetësor dhe menaxhimit të tij në jugun dhe veriun e Mitrovicës. Në të krahasohen shërbimet shëndetësore të ofruara në të kaluarën dhe tani, si dhe identifikon çështjet e përbashkëta që shqetësojnë të gjitha komunitetet e Mitrovicës, siç është helmimi me plumb.

Një problem i përbashkët për një qytet të ndarë: helmimi me plumb

Mitrovica dikur kishte një ndër industritë më të mëdha të minierave në rajon. Me afro 23,000 punonjës, kompleksi i minierave Trepça dikur ishte një nga kompanitë më të mëdha në Jugosllavinë socialiste.¹²⁴ Kompleksi i minierave Trepça përqendrohej në nxjerrjen e plumbit, zinkut dhe kadmiumit, si dhe në një sasi të arit dhe argjendit.¹²⁵ Fabrika për shkrirjen e plumbit rriti në masë të madhe ndotjen e mjedisit në qytet dhe në rrethinë.¹²⁶

Degradimi mjedisor i shkaktuar nga industria e minierave në Mitrovicë ishte i njohur me vite të tëra. Studimet akademike gjatë viteve të 1980-ta dhe 1990-ta tregonin përmbajtje të lartë të plumbit në ujë, tokë dhe ajër në Mitrovicë.¹²⁷ Rezultatet e Vlerësimit të rrezikut të OBSH-së të kryer në vitin 2004 konfirmuan se rreziku i sigurisë shëndetësore nga ekspozimi i plumbit ishte serioz. Në komunat e Mitrovicës dhe Zveçanit, 25 për qind të fëmijëve të testuar të moshës dy deri tre vjeçe, kishin nivele të larta të plumbit në gjakun e tyre.¹²⁸

Kontaminimi me plumb nuk ndalon në lumin Ibër; ai është problem i përbashkët me të cilin përballen njerëzit që jetojnë në të dyja anët. Helmimi me plumb paraqet rrezik të rëndë për tërë popullatën e Mitrovicës.¹²⁹ Megjithatë, profesionistët shëndetësorë në vend nuk mendojnë që helmimi me plumb është problem serioz shëndetësor. Sipas Dr. Sanije Mehollit, Drejtoreshë e Shtëpisë së Shëndetit në Mitrovicë, qytetarët e Mitrovicës nuk vuajnë nga asnjë sëmundje e veçantë. “Mund të ndodhë që Trepça të ketë pasur ndikim në shëndetin e qytetarëve më herët, mirëpo tani nuk ndikon shumë,” thotë ajo.¹³⁰ Përveç kësaj, Fevzi Sylejmani, mjek në Shtëpinë e Shëndetit i cili ishte i përfshirë në testimin e

¹²⁴ Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), Trepça: Gjiganti industrial i Kosovës, qershor 2003, mund ta gjeni në: http://www.esiweb.org/index.php?lang=en&id=298&city_ID=34.

¹²⁵ ESI, “Trepça 1965-2000: Raport për MMA (mësimet e mësuara dhe analizë)” nga Micheal Palairt, qershor 2003.

¹²⁶ Raporti i OSBE-së, “Kontaminimi me plumb në Mitrovicë që prekë komunitetin rom,” shkurt. 2009, f. 3.

¹²⁷ Human Rights Watch, “Kosova: E helmuar me plumb: Kriza shëndetësore dhe e të drejtave të njeriut në Kampet e romëve në Mitrovicë,” qershor 2009, f. 22.

¹²⁸ Organizata Botërore e Shëndetësisë, Komiteti rajonal për Evropën, “Avancimi i sigurisë shëndetësore: sfidat në Rajonin evropian të OBSH-së dhe përgjigja e sektorit të shëndetësisë,” 2006, f. 8.

¹²⁹ Human Rights Watch, “E helmuar me plumb: Krizë shëndetësore dhe e të drejtave të njeriut në Kampet e romëve në Mitrovicë,” qershor 2009, f. 37.

¹³⁰ Intervistë e IKS-it me Dr. Sanije Mehollit, drejtoreshë e Shtëpisë së shëndetit, Mitrovicë, 07 korrik, 2009.

plumbit për komunitetin rom, mendon se qytetarët e Mitrovicës nuk kanë probleme me helmimin me plumb.¹³¹

Z. Skender Sylja, Udhëheqës i zyrës së OBSH-së në Prishtinë, ishte i befashuar me deklaratat e mjekëve të Mitrovicës mbi helmimin me plumb. “Është absurde të thuhet se Mitrovica nuk ka problem me kontaminim me plumb,” tha ai. “Kontaminimi i Mitrovicës me plumb është një nga temat më të nxehta në Evropë.”¹³² Në qershor të vitit 2000, KFOR-i filloi të pranojë informata mbi testimet e gjakut që tregonin nivele të larta të kontaminimit me plumb në radhët e trupave ndërkombëtare të stacionuar në Mitrovicë. Bazuar në këtë informatë, UNMIK-u vendosi të mbyllë fabrikën e Trepçës në gusht të vitit 2000 dhe të analizojë situatën, me ndihmën e konsulentëve të jashtëm, KFOR-it dhe punonjësve lokalë shëndetësorë.¹³³

Përkundër këtij problemi të përbashkët shëndetësor – të mohuar nga punonjësit shëndetësorë shqiptarë për arsye të çuditshme – ndarjet etnike ndërmjet komuniteteve në të dyja anët e Mitrovicës kanë kontribuar në mungesën e angazhimeve të përbashkëta për trajtimin e helmimit me plumb. Edhe pse vlerësimi shëndetësor tregon që helmimi me plumb përbën shqetësim serioz për të gjithë grupet etnike që jetojnë në Mitrovicë, asnjë angazhim i përbashkët nuk është ndërmarrë në mënyrë që të adresohet ky problem. Institucionet kosovare në përgjithësi dhe Ministria e shëndetësisë në veçanti nuk mund të kenë qasje në veriun e Mitrovicës. Si rrjedhojë, Ministria nuk mund të ndërmarrë masa për adresimin e helmimit me plumb. Sipas Human Rights Watch, “është bërë pak progres nga ana e agjencive ndërkombëtare apo institucioneve të Kosovës në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për trajtimin e kontaminimit me metale të rënda në rajonin e Mitrovicës si tërësi.”¹³⁴ OBSH-ja ka bërë thirrje për koordinim dhe komunikim më të mirë ndërmjet institucioneve shëndetësore dhe ka ofruar mundësinë e sigurimit të asistencës teknike.¹³⁵

Mirë se vini në spitalin e Mitrovicës së jugut

Pasi janë dëbuar nga spitali i veriut të Mitrovicës në vitin 1999, mjekët shqiptarë improvizuan duke themeluar një spital brenda ndërtesës së Shtëpisë së Shëndetit në jugun e Mitrovicës.¹³⁶ Gjysma e ndërtesës trekateshe të Shtëpisë së Shëndetit është ndarë për shfrytëzim të spitalit të Mitrovicës së jugut. Megjithatë, infrastruktura e dobët, pajisjet joadekuate, resurset e pakta njerëzore dhe medikamentet e pamjaftueshme shkaktuan

¹³¹ Grupi i fokusit i IKS-it me përfaqësues të institucioneve shëndetësore në Mitrovicë dhe të qytetarëve. Fevzi Sylejmani, mjek në Shtëpinë e shëndetit, Mitrovicë, 23 korrik, 2009.

¹³² Intervistë e IKS-it me Skender Sylën, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Kryesues i zyrës, Prishtinë, 13 gusht, 2009.

¹³³ Human Rights Watch, “Kosova: E helmuar me plumb: Kriza shëndetësore dhe e të drejtave të njeriut në Kampet e romëve në Mitrovicë,” qershor 2009, f. 22.

¹³⁴ *Po aty*, f. 35.

¹³⁵ Intervistë e IKS-it me Skender Sylën, Organizata Botërore e Shëndetësisë, Kryesues i zyrës, Prishtinë, 13 gusht, 2009.

¹³⁶ Shtëpia e shëndetit ofron kujdes shëndetësor primar dhe nuk posedon kushte për ofrimin e shërbimeve sikurse ato të spitalit.

vështirësi për mjekët në ofrimin e shërbimeve cilësore.¹³⁷ Pesë shtretërit e vetëm janë vazhdimisht të zënë nga pacientë që marrin trajtim të dializës.

Përveç kësaj, njerëzit duhet t'u shmangen sëmundjeve në orët e pasdites në jugun e Mitrovicës. Ndonëse orari zyrtar i punës në spital është prej 07:00 deri në 14:00, shumica e mjekëve largohen rreth mesditës. Sipas Drejtorit operativ, kjo është si rrjedhojë e pagave të ulëta. Mjekët duhet t'i kalojnë orët e pasdites duke punuar në klinikat private në mënyrë që të fitojnë bukën e gojës. “Unë jam në dijeni që mjekët lënë punën para së të përfundojë orari i punës, por meqë unë nuk jam në gjendje t'i paguaj ata më shumë, unë i lejoj të shkojnë të punojnë në klinikat e tyre private,” tha ai.¹³⁸

“Shyqyr Zotit unë jam në gjendje të mirë financiare dhe mund të shkoj në klinika private,” tha Hysni Ibrahim, ish pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që jeton në Mitrovicë dhe vuan nga një lëndim në këmbë. Ai ka vizituar spitalin e jugut të Mitrovicës rregullisht që prej vitit 1999. Megjithatë, “spitali nuk është në gjendje të ofrojë shërbime për qytetarët,” thekson ai.¹³⁹ Prandaj, ai paguan çmime më të larta për t'u trajtuar në klinika private. Fatkeqësisht, jo të gjithë qytetarët mund të përballojnë çmimet goxha më të larta të klinikave private.

Spitali posedon vetëm dy autoambulanca: një për nevoja lokale dhe një për nevoja rajonale. Vetëm njëra autoambulancë është përgjegjëse për transportimin e pacientëve nga Mitrovica për në Prishtinë. Nëse ajo është e zënë apo në rrugë për në Prishtinë, pacientët tjerë duhet të organizojnë vetë transportin. Si rezultat, ka pasur disa raste kur pacientët kanë vdekur rrugës për në Prishtinë.¹⁴⁰ Ndërkohë, një spital plotësisht i pajisur ekziston vetëm pak minuta larg, matanë urës.

Në kushte të tilla, vështirë se mund të thuhet që kujdesi shëndetësor sekondar ofrohet në jugun e Mitrovicës; “spitali” ekziston vetëm në letra zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë. Shërbimi i vetëm për të cilin “spitali” është i pajisur është kujdesi për shtatzënat. Megjithatë, nëse paraqiten komplikime gjatë lindjes, gratë dërgohen me nxitim drejt Prishtinës, në rrugën afro 45 minutëshe. Ndryshe nga jugu i Mitrovicës, ajo ka pajisje të operimit.

Spitali i paarritshëm

Spitali rajonal i Mitrovicës me mbi 14,000 metra katrorë gjendet në pjesën veriore të qytetit. Para vitit 1999 ai administrohej nga ‘organizata e përbërë e punës së bashkuar’ dhe quhej Qendra mjekësore “30 korriku.”¹⁴¹ Qendra mjekësore ishte përgjegjëse për

¹³⁷ Intervistë e IKS-it me Bajram Pretenin, Endokrinolog, Spitali i Mitrovicës. 21 korrik, 2009.

¹³⁸ Intervistë e IKS-it me Ixhmet Rexhepin, ish Zëvendësdrëjtor i Spitalit të veriut të Mitrovicës. 27 korrik, 2009.

¹³⁹ Hysni Ibrahim, grupi i fokusit i IKS-it, Mitrovicë, gusht 2009.

¹⁴⁰ Intervista të IKS-it me stafin mjekësor në spital, 07 korrik, 2009.

¹⁴¹ Organizatë socialiste e cila ishte përgjegjëse për menagjimin e sektorit shëndetësor.

menaxhimin e institucioneve shëndetësore në rajonin e Mitrovicës, duke përfshirë spitalin e Mitrovicës dhe qendrat shëndetësore në Leposaviç, Zubin Potok, Vushtrri dhe Skenderaj. Rreth 1,200 shqiptarë dhe serbë ishin të punësuar vetëm në spital. Bashkëpunimi ndërmjet dy komuniteteve ishte i kënaqshëm.

Me 18 reparte dhe 756 shtretër, spitali kishte kapacitet për të asistuar një numër të madh të qytetarëve. Reparti i lindjes shfrytëzohej për lindjen e rreth dhjetë deri dymbëdhjetë mijë foshnjave në vit. Njerëzit udhëtonin për në Mitrovicë nga të gjitha anët e Kosovës për të marrë trajtim mjekësor. Rastet urgjente udhëzoheshin për në Beograd.¹⁴² “Shërbimet e ofruara në Spitalin rajonal të Mitrovicës ishin të shkëlqyeshme,” kujton Ixhmet Rexhepi, Drejtor operativ i Spitalit rajonal të Mitrovicës. “Spitali i Mitrovicës ishte njëri ndër më të mirët në rajon. Ndodhte që rastet transferoheshin nga Prishtina për në Mitrovicë, për shkak të shërbimeve më të mira.”¹⁴³

Tani qendra mjekësore udhëhiqet nga institucionet paralele serbe dhe quhet “*Kosovska Mitrovica*.” Ajo ofron kujdes shëndetësor primar në Leposaviç dhe Zubin Potok si dhe kujdes shëndetësor sekondar në veriun e Mitrovicës. Gjersa shërbimet janë shumë të kufizuara në jugun e Mitrovicës, ai në pjesën veriore ofron të gjitha shërbimet e nevojshme spitalore.

Qendra mjekësore financohet nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Serbisë dhe funksionon nën autoritetin e saj.¹⁴⁴ Në vitin 2008, qeveria e Serbisë investoi mbi 62 milionë Euro në sektorin e shëndetësisë në Kosovë.¹⁴⁵ Punonjësit mjekësorë në veri janë të paguar mirë, marrin rroga si nga Qeveria e Serbisë ashtu dhe nga Qeveria e Kosovës. Gjithsej 6,847 punonjës të qendrave paralele serbe shëndetësore në Kosovë paguhen nga Qeveria e Serbisë.¹⁴⁶ Përmes financimit të fortë, Qeveria e Serbisë mban ndikimin e saj mbi serbët e Kosovës. Megjithatë, për shkak të krizës globale financiare, punonjësit mjekësorë serbë që dikur merrnin paga shtesë në shumë të 100 për qind të rrogës fillestare, tani marrin vetëm gjysmën e kësaj.¹⁴⁷ Ata ende janë të paguar mirë krahasuar me homologët e tyre shqiptarë në jug. Megjithatë, sipas zëvendës drejtorit për Çështje mjekësore të Spitalit të veriut të Mitrovicës, atyre u mungon motivi për punë.¹⁴⁸ Por jo të gjithë mjekët e veriut të Mitrovicës janë pajtuar me këtë, madje disa kanë kërkuar më shumë staf dhe pajisje shtesë.

¹⁴² Intervistë e IKS-it me Ixhmet Rexhepin, ish Zëvendës drejtor i Spitalit të veriut të Mitrovicës. 27 korrik, 2009.

¹⁴³ Intervistë e IKS-it me Ixhmet Rexhepin, ish Zëvendës drejtor i Spitalit të veriut të Mitrovicës. 27 korrik, 2009.

¹⁴⁴ Intervistë e IKS-it me Dr. Orlovic, ish Drejtor i Qendrës mjekësore *Kosovska Mitrovica* dhe aktualisht Këshilltar i Drejtorit të Qendrës mjekësore, shtator 2009.


¹⁴⁵ Transparency Serbia, “Gjurmimi i fondeve nga Serbia për në Kosovë-Metohi,” Beograd, qershor 2009 (ende nuk është publikuar). Shuma totale e financave të planifikuara nga fondi shëndetësor i Qeverisë së Serbisë është 5.855.817.000 RSD. IKS-i ka konvertuar këtë shumë në Euro, me normë të këmbimit 0.0104554 më 8 dhjetor, 2009. Shuma në euro është 61.224.909.06. Faqja e internetit për norma të këmbimit është: <http://www.xe.com/>.

¹⁴⁶ *Po aty*, f. 48.

¹⁴⁷ Intervistë e IKS-it me Dr. Orlovic, shtator 2009.

¹⁴⁸ Intervistë e IKS-it me Dr. Zvonko Radosavljevic, Zëvendës drejtor për Çështje mjekësore, Spitali i veriut të Mitrovicës, shtator 2009.

Në gusht të vitit 2008, Inicijativa Kosovare për Stabilitet bëri një anketë në veriun e Mitrovicës. Ndonëse spitali i veriut të Mitrovicës nuk ka problem me financim dhe paga, vetëm 9 përqind e të anketuarve të anketës së IKS-it ishin “shumë të kënaqur” me shërbimet spitalore dhe 29 përqind ishin “të pakënaqur,” ndërsa 31 përqind ishin “të pa vendosur” rreth shërbimeve spitalore (shih diagramin 1.).¹⁴⁹



Qeveria e Kosovës nuk ka fare ndikim në spitalin e veriut të Mitrovicës. Strategjia 2010-2014 parasheh që veriu i Mitrovicës do të ketë spitalin e vet, i cili do të funksionojë nën kompetencat e komunës së veriut të Mitrovicës (siç parashihet me Propozimin e Ahtisaarit).¹⁵⁰

Përkundër kornizës së mjerë zyrtare institucionale dhe konfuzionit rreth kompetencave, bashkëpunimi ndërmjet dy komuniteteve nuk përfundoi tërësisht me luftën. Si serbët ashtu dhe shqiptarët pranojnë se një formë e bashkëpunimit vazhdon, ndonëse jozyrtarisht. Z. Radimir Jankovic, Drejtor i Departamentit të kirurgjisë në Qendrën Mjekësore *Kosovska Mitrovica* theksoi, “Ka shqiptarë që vijnë [në veriun e Mitrovicës] për kirurgji, meqë i besojnë shërbimeve të ofruara nga ne. Megjithatë, nuk ka bashkëpunim zyrtar ndërmjet spitaleve.”¹⁵¹ Shaqir Demiri, drejtor i Drejtoratit të shëndetësisë në Komunën e Mitrovicës, pajtohet që bashkëpunimi ndërmjet dy komunave ekziston, por thekson që relativisht pak shqiptarë shkojnë në spital e veriut të Mitrovicës.¹⁵² Në përgjithësi, prej vitit 1999 spitali nuk ka qenë lehtë i arritshëm për qytetarët që jetojnë në jugun e Mitrovicës.

¹⁴⁹ Anketa është kryer nga IKS-i në gusht të vitit 2009 me përfshirjen e 100 të anketuarve të grupmoshave 18-65 të veriut të Mitrovicës.


¹⁵⁰ Ministria e shëndetësisë, “Strategjia 2010-2014.”

¹⁵¹ Intervistë e IKS-it me Dr. Radimir Jankovic, Kryesues i departamentit të kirurgjisë. Shtator 2009.

¹⁵² Intervistë e IKS-it me Shaqir Demirin, drejtor i Drejtoratit të shëndetësisë në Komunën e Mitrovicës. 21 korrik, 2009.

Kur IKS-i pyeti banorët serbë të veriut të Mitrovicës nëse ata do të shkonin në jugun e Mitrovicës për një kontrollë të nevojshme mjekësore, 76 përqind u përgjigjen jo dhe vetëm 10 përqind thanë se do të shkonin (shih diagramin 2).¹⁵³

Diagrami 2.



Spitali i ri, shpresë e re?

Për dhjetë vite, qytetarët e jugut të Mitrovicës janë privuar nga shërbimet bazike spitalore. Një propozim i parashtruar nga administrata e UNMIK-ut menjëherë pas konfliktit të vitit 1999 shqyrtonte mundësinë e ndërtimit të një spitali të ri në jugun e Mitrovicës për ofrimin e qasjes më të mirë në kujdesin shëndetësor. Megjithatë, një numër i qytetarëve në jugun e Mitrovicës kundërshtoi atë propozim sepse do të nënkuptonte “pranimin” e ndarjes së Mitrovicës në një ndarje etnike veri dhe jug. Siç edhe parashtrroi pyetjen Drita Fazliu, drejtoreshë e Spitalit rajonal të jugut të Mitrovicës, “Pse të ndërtohet një spital i ri, kur ne veçse e kemi një [në veri]?”¹⁵⁴

Për dhjetë vite, shumë njerëz që jetojnë në jug janë mbajtur me shpresën se spitali në veri do të bëhet i arritshëm edhe për ta, sikurse ishte dikur. “Ne nuk deshëm të kemi një spital të ri. ... Ne nuk kemi nevojë për të meqë veçse e kemi një në qytet,” theksoi Ixhmet Rexhepi, Drejtor operativ i Spitalit të jugut të Mitrovicës. Megjithatë, pas dhjetë viteve të të jetuarit në harresë, pa qasje në kujdes cilësor shëndetësor, qytetarët kanë filluar të pranojnë se mund të mos ketë alternativë tjetër. “Për shkak të arsyeve politike u desh të pranojmë idenë e një spitali të ri,” shtoi Rexhepi.¹⁵⁵

¹⁵³ Anketë e IKS-it. Gusht 2009.

¹⁵⁴ Intervistë e IKS-it me Drita Fazliun, drejtoreshë e Spitalit rajonal të Mitrovicës, jug. 21 korrik, 2009.

¹⁵⁵ Intervistë e IKS-it me Ixhmet Rexhepin, ish zëvendësdirjtor i Spitalit të veriut të Mitrovicës. 27 korrik, 2009.

Të gjitha shpresat për një sistem të integruar shëndetësor në Mitrovicë u zbehën në masë të madhe pas Propozimit të Ahtisaarit. Ky Propozim rekomandonte që Mitrovica të ndahet në dy komuna, Veri dhe Jug, me një Bord të përbashkët për të dy komunat. Komuna veriore do të ketë kompetenca të zgjeruara, duke përfshirë ofrimin e kujdesit shëndetësor sekondar.¹⁵⁶ Kjo qasje është përfshirë në Strategjinë e sipërpërmendur të Ministrisë së Shëndetësisë për 2010-2014. Meqë banorët e jugut të Mitrovicës nuk do të kenë qasje në spitalin në veri, shfaqet një nevojë e menjëhershme për të siguruar qasje në shërbime spitalore për banorët e jugut.

Ndërtesa e spitalit është në ndërtim e sipër. Gjysma e ish spitalit Maroken në jugun e Mitrovicës tanimë është rinovuar me donacion të qeverisë norvegjeze. Norvegjia është zotuar të dhurojë pesë milionë Euro donacion, dy milionë prej të cilave veçse janë investuar. Ministria e Shëndetësisë ka investuar gjysmë milionë Euro në pajisje. Spitali do të ketë kapacitet prej 212 shtretërve.¹⁵⁷

Spitali i ri shihet si zgjidhje praktike. Megjithatë, sfidat e menaxhimit të mirëfilltë të spitalit, veçanërisht resurset njerëzore, mund të vazhdojnë për vitet në vijim. Në dekadën e fundit, 15 mjekë tanimë kanë lënë Mitrovicën duke shkuar në Prishtinë dhe Vushtrri, ku mund të ushtrojnë profesionet e tyre. Spitali i ri do të ketë nevojë të angazhojë 67 mjekë, 140 infermiere dhe 58 pjesëtarë të stafit teknik. Për më tepër, moshja mesatare e stafit aktual është 53 vjeçe dhe sipas gjasave ata do të përballen me vështirësi në përdorimin e pajisjeve të reja.

Konkludim

Ndarja e qytetit të Mitrovicës në dy komuna me dy spitale rrezikon ndarjen e mëtutjeshme të sektorit të saj të shëndetësisë. Me spitale të ndryshme, në veri dhe në jug, nuk ofrohet asnjë stimulim për bashkëpunimin ndërmjet dy komuniteteve në të dyja anët. Për më tepër, kjo nënkupton pranimin e ndarjes etnike në Mitrovicë që ekziston që një dekadë tani.

Një mënyrë e shmangies së ndarjeve të mëtutjeshme është që spitali i ri në jug të Mitrovicës të përqendrohet në ofrimin e shërbimeve të cilat nuk ofrohen në spitalin verior. Në këtë mënyrë spitalet do të mund ta plotësojnë njëri-tjetrin, duke mundësuar bashkëpunimin e ardhshëm. Veç kësaj, me mbështetje të donatorëve dhe qeverisë, të dy spitalet do të mund të ndihmoheshin që të specializohen në ofrimin e shërbimeve të cilat nuk ofrohen nga spitalet tjera në rajon. Kjo do të ndihmonte jo vetëm në lehtësimin e bashkëpunimit ndërmjet komuniteteve, por edhe që Mitrovica të rikthejë krenarinë e saj të zotërimit të spitalit(ëve) më të mirë në rajon, me përfitime potenciale ekonomike, duke joshur pacientë nga rajoni.

¹⁵⁶ “Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës,” në dispozicion në: <http://www.unosek.org>.

¹⁵⁷ Intervistë e IKS-it me Ixhmet Rexhepin, ish drejtor i Spitalit të veriut të Mitrovicës. 27 korrik, 2009.

Nëse dëshirojmë të shohim përparim në integrimin e qytetit dhe përmirësimin e shërbimeve shëndetësore që janë kyçe për kthimin dhe integrimin e qëndrueshëm, duhet përkushtim afatgjatë, i fuqishëm dhe i kujdesshëm, posaçërisht nga ana e qeverisë qendrore dhe lokale, por edhe nga ICO-ja dhe donatorët. Universiteti Evropian i Mitrovicës (propozim i ESI-t, 2004) do të mund të përqendrohej në përgatitjen e profesionistëve të rinj të shëndetësisë për një sistem të integruar shëndetësor në Mitrovicë.

Për më tepër, Qeveria e Kosovës duhet të shtojë financimin e saj për shëndetësinë në Mitrovicë në mënyrë që t'i përmirësojë shërbimet dhe në këtë mënyrë të parandalojë fluksin e qytetarëve të Mitrovicës në pjesë tjera të Kosovës. Po ashtu, qeveria e Kosovës duhet të shfrytëzojë mundësinë që i ofrohet nga kriza globale financiare që të shtyjë mjekët serbë të bashkëpunojnë me homologët e tyre në jug.

Identifikimi i zgjidhjeve për problemet e përbashkëta, siç është helmimi me plumb, mund të ofrojnë mundësi për serbët dhe shqiptarët që t'i bashkojnë forcat në përmirësimin e gjendjes shëndetësore në Mitrovicë. Urgjentisht nevojitet një koordinim më i madh ndërmjet institucioneve kosovare dhe përfaqësuesve lokalë serbë. Duhet të bëhen përpjekje për të shfrytëzuar bashkëpunimin tanimë ekzistues ndërmjet dy komuniteteve.

PROÇESI I KTHIMIT NË MITROVICË

Përderisa çështja e personave të zhvendosur ka prekur të gjitha komunitetet në Kosovë pa dallim, kjo analizë e politikave argumenton se kthimi i personave të zhvendosur në pronat e tyre është politizuar, duke ndërlikuar një çështje të rëndësishme si për të drejtat e njeriut ashtu edhe për stabilitetin e vendit.

Hulumtimi ynë në terren përkrahë mendimin se zhvillimi ekonomik, arsimimi i mirë, punësimi dhe zvogëlimi i shkallës së varfërisë janë prioritetet kryesore të qytetarëve të Mitrovicës pa marrë parasysh kombësinë e tyre.

Kjo analizë e politikave mëton të tregojë se problemet socio-ekonomike bashkojnë qytetin e ndarë të Mitrovicës. Identifikimi i problemeve të përbashkëta mund të ndihmojë në krijimin e besimit të ndërsjellë në mes të komuniteteve të ndara, duke krijuar parakushtet themelore për kthimin e personave të zhvendosur.

Të politizuar dhe të frikësuar?

Përderisa çështja e zhvendosjes ka prekur të gjitha komunitetet në Mitrovicë, duket se serbët janë komuniteti më pengues ndaj procesit të kthimit, e në veçanti ata që kanë prona në pjesën jugore të qytetit. Edhe pse, shumë të zhvendosur nga jugu i Mitrovicës tashmë kanë shitur pronat dhe nuk mendojnë të kthehen kurrë më. Në zonat rurale të komunës, procesi i kthimit duket më i kënaqshëm, pjesërisht për shkak të faktit se zonat rurale të banuara me serbë nuk janë prekur shumë nga zhvendosja.¹⁵⁸

Shumë serbë të zhvendosur nga pjesë të tjera të Kosovës janë vendosur në veriun e Mitrovicës, përfshirë edhe të zhvendosurit nga pjesa jugore e qytetit. Si rezultat i kësaj, Mitrovica e veriut është shndërruar në qendër urbane për serbët e Kosovës. Përderisa disa serbë kanë tentuar të kthehen në pjesën jugore, deri tani vetëm një familje ia ka dalur të kthehet.¹⁵⁹ Megjithatë, sipas një raporti të Sekretarit të Përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) të shtatorit të vitit 2009, “krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka një ngritje modeste të numrit të personave të zhvendosur që janë kthyer.”¹⁶⁰

¹⁵⁸ Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), “Parimi i Lozanës”, 7 qershor 2004. Raporti thekson se “shumica dërmuese e serbëve ruralë kurrë nuk janë larguar nga Kosova, madje as gjatë periudhës më turbulente të viteve 1999/2000. Shumica sigurojnë jetesën nga bujqësia, edhe pse kushtet janë të rënda, ata janë relativisht të kënaqur”. (f. 8). Mund të gjendet në adresën: http://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_53.pdf.

¹⁵⁹ Intervistë e IKS me Merima Demiroviq, Zyrtare e Lartë për Kthim në Komunën e Mitrovicës, shtator 2009.

¹⁶⁰ Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, “Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovës,” S/2009/497. 30 Shtator, 2009. f. 7-8. Mund të gjendet në adresën: <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N09/521/20/PDF/N0952120.pdf?OpenElement>

Komuniteti i serbëve të Kosovës varet në masë të madhe prej ndihmës financiare nga Qeveria e Serbisë. Duke qëndruar në veri, ata kanë të drejtë në subvencione financiare nga Qeveria. Kjo varësi bën që serbët e Kosovës potencialisht t'i nënshtrohen ndikimit të Qeverisë së Serbisë. Zyrtarët në Beograd shpesh dekurajojnë integrimin e serbëve të Kosovës në shoqërinë kosovare.

Liria e lëvizjes ka shënuar përmirësim nga viti 2005¹⁶¹ dhe siç do të paraqitet në vijim të kësaj analize, duket se mungesa e lirisë së lëvizjes nuk paraqitet më tej si pengesë për kthimin e serbëve në shtëpitë e tyre. Sipas “Raportit të Progresit për Kosovën” (2009) të Komisionit Evropian, *perceptimi* i kërcënimit është faktor i rëndësishëm që kontribuon në numrin e vogël të të kthyerve.¹⁶² Për shembull, një serb nga Kosova që jeton në Mitrovicë të veriut i tha IKS-it se ai kalon urën që shpie në Mitrovicën e jugut vetëm kur është i *detyruar*, do të thotë rrallë herë, ngase frikësohet se mund t'i ndodh diçka, megjithëse e pranon se asnjëherë nuk ka pasur telashe atje.¹⁶³

Mediat serbe dhe politikanët në Beograd kontribuojnë në ndjelljen e ndjenjës së pasigurisë tek serbët e Kosovës, duke e penguar kështu kthimin në pronat e tyre dhe integrimin e tyre.¹⁶⁴

Sipas Policisë së Kosovës, numri i incidenteve ndëretnike në Mitrovicë ka rënë dukshëm, nga 166 në vitin 2004 në vetëm 8 në vitin 2007.¹⁶⁵ Disa qytetarë serbë e kalojnë rregullisht urën pa hasur ndonjë problem.¹⁶⁶

Serbët lëvizin lirshëm në rrugët e jugut të Mitrovicës, vizitojnë restaurantet dhe ngasin makinat e tyre me regjistrime të Serbisë. Edhe pse disa serbë ankohen në lidhje me lirinë e lëvizjes, sipas Ylber Hysës, këshilltar politik i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, lëvizja e lirë ka të bëjë më shumë me barriera psikologjike. Ai shton:

Çdo ditë shoh serbë [në jugun e Mitrovicës]. Shoh klerikë [ortodoksë serbë] me makinat e tyre çdo ditë, përderisa në veriun e Mitrovicës nuk mund të lëvizet me tabela KS [tabela të Kosovës]. Unë nuk besoj se ka ndonjë vend tjetër në Kosovë

¹⁶¹ Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. S/2005/335, 23 maj 2005. Mund të gjendet në: <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N05/339/18/PDF/N0533918.pdf?OpenElement>.

¹⁶² Komisioni Evropian, “Raporti i Progresit për Kosovën,” 2009 f.20. Mund të gjendet në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/ks_rapport_2009_en.pdf.

¹⁶³ Intervistë e IKS me një qytetar nga veriun e Mitrovicës.

¹⁶⁴ Shih analizën nga Iniciativa Rinore për të Drejtat e Njeriut, “Gazetarët mund t’ia dalin”, f.447, Beograd-Prishtinë, 2005. Mund të gjendet në: <http://www.yihr.org/uploads/publications/eng/8.pdf>.

¹⁶⁵ Sipas Policisë së Kosovës këto raste gjithashtu përfshijnë raste të dëmtimit të pronës së lëvizshme dhe palëvizshme, sulmet, shkaktimin e rrezikut të përgjithshëm, etj. dhe nuk paraqesin domosdoshmërisht krime ndëretnike. Megjithatë statistikën nga Policia e Kosovës tregojnë rritje të numrit të incidenteve ndëretnike në vitin 2008 dhe 2009, të cilat sipas tyre kryesisht janë incidente që ngjajnë në Lagjen e Boshnjakëve dhe në Kroin e Vitakut, kur radikalët serbë kundërshtojnë kthimin e shqiptarëve në pronat e tyre në veri.

¹⁶⁶ Intervistë e IKS me qytetarë të veriut të Mitrovicës.

ku mund të shohësh më shumë serbë apo të dëgjosh më shumë të flitet gjuha serbe se sa në Mitrovicë.¹⁶⁷

Si rrjedhojë shfaqen dy sfida që potencialisht pengojnë kthimin e serbëve të Kosovës në shtëpitë e tyre në përgjithësi dhe në jugun e Mitrovicës në veçanti. Sfida e parë është politizimi i procesit të kthimit nga Qeveria e Serbisë. Sfida e dytë, e ndërlidhur me sfidën e parë është perceptimi i rrezikut për sigurinë.

Megjithatë, jo të gjithë serbët e Kosovës janë nën ndikim e zyrtarëve të Beogradit; 22 parti politike serbe (nga numri i përgjithshëm prej 76 partive politike në nivel të Kosovës) kanë deklaruar pjesëmarrjen e tyre në zgjedhjet e 15 nëntorit të vitit 2009.¹⁶⁸ Sipas rezultateve të zgjedhjeve komunale të dhëna nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) serbët e Kosovës kanë votuar në gjashtë komuna në jug të lumit Ibër: Graçanicë, Ranillug, Kllokot, Shtërpçë, Novobërdë, Gjilan dhe Fushë Kosovë.¹⁶⁹

Në një raport të Grupit Ndërkombëtar të Krizave (ICG, 2009) thuhet se “Qeveria e Serbisë ka filluar një qasje të re në Kosovë dhe në përgjithësi i ka dhënë serbëve të atjeshëm më shumë liri veprimi në gjetjen e zgjidhjeve të tyre praktike për problemet ditore.”¹⁷⁰ Mbetet të shihet nëse kemi të bëjmë me ndryshim të qasjes apo vetëm me një lëvizje taktike.

Ekonomi e dobët, shërbime të dobëta publike, gjasa të vogla për kthim

Procesi i kthimit nganjëherë perceptohet nga serbët e Kosovës edhe si mundësi për përfitime materiale.¹⁷¹ Zyrtarët komunalë të Mitrovicës kanë vërejtur kohëve të fundit një rritje të numrit të serbëve që kërkojnë ndihmë nga autoritetet komunale dhe komuniteti ndërkombëtar për t’u kthyer në jugun e Mitrovicës, në veçanti nëse shtëpitë e tyre do të ndërtoheshin apo rinovoheshin. Personat e zhvendosur brenda vendit kanë të drejtë në shtëpi. Nëse shtëpia e tyre është e shkatërruar, ata mund të përfitojnë ndihmë financiare nga organizatat ndërkombëtare për rindërtimin apo rinovimin e saj. Pasi që programi ka për qëllim të inkurajojë kthimin e qëndrueshëm, autoritetet i shqyrtojnë të gjitha kërkesat e tilla me kujdes ngase nuk duan që të financojnë rindërtimin e projekteve nëse prona në fjalë do të shitet menjëherë pas përfundimit të procesit.¹⁷²

¹⁶⁷ Intervistë e IKS-it me Ylber Hysën, Këshilltar Politik i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës, tetor 2009.

¹⁶⁸ Republika e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, “Zgjedhjet 2009 në Kosovë – Përmbledhje” (azhurnimi i fundit më 12 nëntor 2009). <http://www.kqz-ks.org/>

¹⁶⁹ Republika e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve “Rezultatet e Zgjedhjeve të Kryetarëve të Komunave 2009” www.kqz-ks.org. Zgjedhjet në veriun e Mitrovicës dhe Partesh nuk janë mbajtur për shkak të pritjes së krijimit të ekipeve përgatitore për decentralizim.

¹⁷⁰ Grupi Ndërkombëtar i Krizave, “Integrimi i serbëve në Kosovë, marrja e vendimit,” 12 maj 2009, f.3, Mund të gjendet në: [http://www.reliefweb.int/rw/RWFiles2009.nsf/FilesByRWDocUnidFilename/PSLG-7RYJUJY-full_report.pdf/\\$File/full_report.pdf](http://www.reliefweb.int/rw/RWFiles2009.nsf/FilesByRWDocUnidFilename/PSLG-7RYJUJY-full_report.pdf/$File/full_report.pdf).

¹⁷¹ Intervistë e IKS me Bedri Sadikun, Zyrtar Lokal për Kthim në Komunën e Mitrovicës, tetor 2009.

¹⁷² *Po aty*.

Në një raport të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së thuhet se “reintegrimi i komuniteteve pakicë, në veçanti i komunitetit serb të Kosovës, vazhdon të paraqesë një sfidë, së pari për shkak të mungesës së mundësive për punësim, gjendjes së brishtë ekonomike, qasjes në shërbime e deri në një masë të caktuar, edhe për shkak të sigurisë.”¹⁷³

Zhvillimi ekonomik mbetet sfida kryesore me të cilën ballafaqohen jo vetëm të kthyerit por të gjithë kosovarët, e veçanërisht banorët e Mitrovicës. Banka Botërore ka konkluduar se Mitrovica ka normat më të larta të papunësisë dhe normat më të ulëta të punësimit në nivel vendi.¹⁷⁴ Qeveria e Kosovës duhet urgjentisht të zhvillojë politika për zhvillim ekonomik. Këto politika duhet të marrin në konsideratë numrin e personave të zhvendosur dhe një plan për adresimin e nevojave të të kthyerve. Në fakt, kjo do të jetë një nga prioritetet e Strategjisë së MKK 2009-2013, e cila ende nuk është miratuar.

Shërbimet e dobëta publike dhe ankesat mbi punën e komunës paraqesin një problem tjetër të përbashkët për të dyja anët e qytetit. Një qytetar i Mitrovicës, i kombësisë shqiptare, shpreh pakënaqësinë e tij kështu:

Në asnjë mënyrë nuk jam i kënaqur. Gjendja e furnizimit me ujë dhe energji elektrike është katastrofë. Unë paguaj për grumbullimin e mbeturinave, por ata kurrë nuk vijnë. Problemi më i madh është se komuna nuk është duke bërë asgjë sa i përket shtëpisë sime në veri. Në të jetojnë serbë, ndërsa unë jam i detyruar të paguaj qira në jug. Më janë premtuar para për pagimin e qirasë për gjashtë vite, por unë nuk kam marrë asgjë.¹⁷⁵

Sfidat për të kthyerit romë: ekonomia dhe arsimimi

Grupi i fundit i personave të zhvendosur u kthye në jugun e Mitrovicës në korrik të vitit 2009. Nga njëzetepesë familje romë që u kthyen të jetojnë në Mëhallën e Romëve njëzet prej tyre ishin nga kampet Çesmin Llug dhe Osterode, të vendosura aty afër.

Bekim Salihu, një nga të kthyerit në mënyrë spontane,¹⁷⁶ pjesëtar i komunitetit rom, ishte i lumtur që u kthye në Kosovë, pa marrë parasysh problemet jetësore me të cilat ballafaqohet ai dhe familja e tij. Ai jetoi në Novi Sad nga viti 1999 deri në 2007 dhe kishte një jetë relativisht të mirë atje. Sipas Bekimit, të ardhurat në Novi Sad janë më të larta se në Kosovë, dhe ka më shumë mundësi punësimi. “Në Novi Sad mund të gjesh

¹⁷³ Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara “Raport i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë.” S/2009/497, 30 shtator 2009, f. 7-8, Mund të gjendet në: <http://daccessdds.un.org/doc/UNDOC/GEN/N09/521/20/PDF/N0952120.pdf?OpenElement>.

¹⁷⁴ Banka Botërore, “Vlerësim i Varfërisë në Kosovë,” 2007.

¹⁷⁵ Intervistë e IKS-it me një qytetar shqiptar, 6 korrik 2009

¹⁷⁶ “Kthimi spontan” bëhet nga familjet, fëmijët dhe grupet që kthehen pa kurrfarë paralajmërimi paraprak (Manuali për Kthim të Qëndrueshëm).

punë më lehtë, ndërsa në Kosovë më duhet të kaloj tërë ditën duke kërkuar gjësende në shporta të bërllokut,” thotë ai.¹⁷⁷ Edhe në këto kushte, ai vendosi të kthehet në Kosovë, në banesën e porsandërtuar në Mëhallën e Romëve të vendosur në jugun e Mitrovicës. Bekimi tha se ai u kthye në vendin e tij ngase e ndjente se përkiste aty.

Mëhalla e Romëve vazhdon të rritet me përkrahjen financiare për ndërtim të shtëpive të reja nga Komuna e Mitrovicës, Norwegian Church Aid, Danish Refugee Council, UNHCR, SIDA, dhe donatorë tjerë. Edhe një numër shtesë i shtëpive të reja do të vihen në dispozicion të individëve si Bekimi. Megjithatë, mbetet pikëpyetje se si do të sigurojnë jetesën personat e zhvendosur që janë kthyer të jetojnë aty.

Deri tani 482 romë janë kthyer në Komunën e Mitrovicës. Shumica prej tyre janë me vendbanim në Mëhallën e lartpërmendur të romëve, e cila i ngjan një lagjeje moderne. Me donacione nga organizata të ndryshme ndërkombëtare janë ndërtuar gjashtë komplekse kolektive banesore krahas rreth tridhjetë shtëpive të cilat do të ndërtohen deri në fund të vitit 2010. Përveç ofrimit të hapësirës për të jetuar, organizatat ndërkombëtare shpesh ofrojnë romëve edhe mundësi punësimi, gjë që do të lehtësonte integrimin e tyre.

Organizatat ndërkombëtare e përkrahin procesin e kthimit përmes tri komponentëve: ndërtimit të shtëpive, sigurimit të asistencës socio-ekonomike dhe zhvillimit të komunitetit. Një projekt i ndërlidhur me këtë është ai i quajtur “Hotel Industria,” i financuar nga Norwegian Church Aid dhe Danish Refugee Council. Komponenti i parë i tij është trajnimi i komunitetit rom në kryerjen e punëve të ndryshme si saldues dhe zdrukthëtarë. Trajnimi ka filluar në shtator të vitit 2009 dhe do të vazhdojë deri në fund të vitit. Çdo javë rreth tetë pjesëtarë të komunitetit rom trajnohen nga tre trajnerë. Më pas, ata që demonstronë gatishmëri më të madhe për të mësuar, si dhe talent në profesionin e caktuar, vazhdojnë punën në fabrikë.

Hysen Mustafa, një qytetar rom 50-vjeçar, është një nga përfituesit e këtij projekti. Ai u kthye në Kosovë në “mënyrë të organizuar”¹⁷⁸ nga Mali i Zi ku jetoi nga viti 1999 deri në vitin 2006. Kur u kthye në jugun e Mitrovicës, ai u bë pronar i banesës dhe iu siguria një vend pune në “Hotel Industria.” “Duke e marrë parasysh nivelin e [lartë të] papunësisë në Kosovë, jam i lumtur që kam një vend pune.” tha ai.¹⁷⁹ Ç’është e vërteta, projekti ka për qëllim të gjenerojë të ardhura për romët, aspekt ky kyç për kthim të qëndrueshëm. Saldimi dhe zdrukthëtaria janë vetëm dy nga disa komponenta. Komponenta tjetër do të jetë e përqendruar në angazhimin e grave.

¹⁷⁷ Intervistë e IKS-it me Bekim Salihun, pjesëtar i komunitetit rom, tetor 2009.

¹⁷⁸ “Kthimet e organizuara” janë grupe të cilat kthehen në mënyrë të organizuar nga institucionet relevante përgjegjëse për kthim (MKK “Manuali për kthim të qëndrueshëm”).

¹⁷⁹ Intervistë e IKS-it me Hysen Mustafën, pjesëtar i komunitetit rom, tetor 2009, Mitrovicë.

Një sfidë tjetër me të cilën ballafaqohet komuniteti rom, si dhe të kthyerit tjerë, është arsimiti. Përderisa Z. Mustafa ishte i lumtur që kthehej në shtëpi, fëmijët e tij u përballën me vështirësi. Gjatë qëndrimit të tyre në Mal të Zi, fëmijët e tij kishin vijuar mësimin në gjuhën serbe. Disa fëmijë që kishin vijuar mësimin në gjuhën serbe gjatë qëndrimit në Mal të Zi dhe në Serbi tani jetojnë në jugun e Mitrovicës, ku gjuha primare është ajo shqipe. Pa një shkollë në gjuhën serbe, atyre do t'u duhet të ecin nga 15 minuta për të vijuar mësimin në shkollat në veriun e Mitrovicës.

Ngjashëm, fëmijët shqiptarë që jetojnë në veri, për shkak të mungesës së shkollave në gjuhën shqipe, vijojnë mësimin në pjesën jugore, për ku udhëtojnë në mënyrë të organizuar, dhe shpesh nën përcjellje të prindërve të tyre për shkak të frikës për sigurinë e tyre. Jugut të Mitrovicës nuk i mungojnë vetëm ndërtesat e shkollave por edhe planprogrami në gjuhën serbe. Përpilimi i planprogramit në gjuhën serbe dhe ndërtimi i shkollave për fëmijët shqiptarë në veri, duhet të jenë mes të prioriteteve të Ministrisë së arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT) pasi që paraqesin masa stimuluese për integrimin e komuniteteve.

Matrica e ndërlikuar e kthimit

Procesi i kthimit është kompleks dhe i ndjeshëm. Ai kërkon koordinim mes tri niveleve të qeverisjes në Kosovë, qeverisë qendrore të Kosovës, ku puna koordinohet nga Ministria për komunitete dhe kthim, qeverive komunale, përmes zyrtarëve të emëruar për komunitete dhe kthim, dhe organizatave ndërkombëtare që operojnë në Kosovë (UNHCR, UNMIK, UNDP). Ndërsa, mijëra serbë të zhvendosur në Serbi përfaqësohen nga Ministria për KM dhe Këshilli i Serbisë për Refugjatë.

Ministria për komunitete dhe kthim (MKK) e Qeverisë së Kosovës është përgjegjëse për udhëheqjen dhe koordinimin e procesit të kthimit. Dokumenti bazik i KMM-së lidhur me personat e kthyer është manuali mbi procesin e kthimit të qëndrueshëm. Përveç këtij dokumenti përshkrues, është e nevojshme që të ekzistojë strategjia për kthim të qëndrueshëm.

MKK ka përpiluar strategjinë për kthimin, por ajo ende nuk është miratuar nga qeveria. Disa nga pengesat e identifikuara në këtë strategji janë: moszbatimi i ligjeve, papunësia, rënia e fondeve për procesin e kthimit, etj. Në mënyrë që të adresohen këto çështje, MKK do të vë mes prioriteteve të veta: ngritjen e kapaciteteve për zbatim të ligjit; bashkëpunimin me ministritë dhe agjencitë relevante për zhvillim ekonomik, në mënyrë që të promovohen mundësitë e punësimit për pakicat; thjeshtësimin e procesit të kthimit për personat e zhvendosur dhe ngritjen e fondeve për kthim.¹⁸⁰ Strategjia për Komunitete

¹⁸⁰ Ministria për komunitete dhe kthim (MKK), "Strategjia për komunitete dhe kthim 2009 – 2013," f. 14.

dhe Kthim parashihet të zbatohet mes viteve 2009-2013, që mund të jetë e vështirë marrë parasysh se viti i parë veçse kaloi.

Shifrat e kontestueshme

Numri i personave të zhvendosur si pasojë e luftës së fundit në Kosovë është i paqartë dhe i kontestueshëm. Shifrat dallojnë varësisht nga institucioni dhe vendi që i jep, ndërsa në masë të gjerë bazohen në supozime si rrjedhojë e mungesës së të dhënave zyrtare mbi numrin e personave të zhvendosur. Raporti i Progresit për Kosovën 2009 i Komisionit Evropian thotë se 200,000 serbë janë të zhvendosur në Serbi dhe 16,000 sish në Mal të Zi.¹⁸¹ Kjo shifër shpesh përdoret edhe nga organizata tjera ndërkombëtare, siç janë UNHCR dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar.

Strategjia e MKK-së për të kthyerit vlerëson se 243,831 persona janë të zhvendosur, bazuar në shifra të UNICEF-it.¹⁸² Ka shumë të ngjarë që këto shifra të jenë të ndikuara nga shifrat e dhëna nga Qeveria e Serbisë e cila pohon se janë 242,381 persona të zhvendosur nga Kosova, nga të cilët 207,500 sish janë serbë.¹⁸³

Sipas regjistrimit jugosllav të popullsisë të vitit 1991, numri i serbëve në Kosovë ishte 194,000.¹⁸⁴ Marrë parasysh se jo të gjithë banorët serbë e kanë lëshuar Kosovën në vitin 1999 (apo më pas) dhe se një numër i madh i serbëve jeton në veriun e Mitrovicës dhe në komunat tjera me shumicë serbe (si p.sh. Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan, Graçanicë, Çagllavicë, Shtërpcë, Novobërdë, Kamenicë, etj.) atëherë shifra prej 242,381 personash të zhvendosur, e cila plasohet nga Qeveria e Serbisë është joreale dhe e ekzagjeruar.

Sipas Inicativës Evropiane për Stabilitet (ESI) shumica e serbëve jetojnë në zona rurale, dhe shumica prej tyre kurrë nuk i kanë lëshuar shtëpitë e veta. Bazuar në numrin e nxënësve të regjistruar në shkolla fillore dhe strukturën moshore të serbëve të Kosovës, ESI parashikon se në Kosovë jetojnë rreth 128,000 serbë. Nëse ky numër i zbritet shifrës prej 194,000 nga regjistrimi i vitit 1991, ESI arrin tek shifra prej 65,000 serbë të zhvendosur. Rrjedhimisht ata arrijnë tek konkluzioni se “Përkundër perceptimit të gjerë, dy të tretat e popullatës serbe nga periudha para luftës në Kosovë në fakt ende jetojnë në Kosovë.”¹⁸⁵ Nga numri i gjithmbarshëm i personave të zhvendosur, supozohet se 20,235 janë të zhvendosur brenda Kosovës.¹⁸⁶

¹⁸¹ Raporti i Progresit në Kosovë 2009 i Komisionit Evropian.

¹⁸² Kjo strategji e MKK-së ende nuk është publikuar.

¹⁸³ Uebfaqja e Qeverisë së Serbisë <http://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/?id=8929>.

¹⁸⁴ ESI, “Parimi i Lozanës” 2004, f. 7-8.

¹⁸⁵ ESI, “Parimi i Lozanës” 2004, f. 6-8.

¹⁸⁶ Strategjia e MKK-së për të kthyerit.

Numri i të kthyerve

Deri në dhjetor të vitit 2008, 18,505 persona janë kthyer në shtëpitë e tyre (shih Tabelën 1 më poshtë). Numri i personave të kthyer për vit dhe në total, i ndarë sipas grupeve etnike, tregon se gjithsej 7,929 serbë të Kosovës janë kthyer në Kosovë pas konfliktit, që do të thotë se numri i refugjatëve serbë sot është rreth 57,000.

Tabela 1. Komunitetet pakicë të kthyer në Kosovë nga viti 2000 deri në dhjetor të vitit 2008¹⁸⁷

Etnia	Viti									Total	%
	2000	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008		
Serbë	1826	679	966	1550	818	740	615	580	155	7929	42.84
Romë	20	214	390	287	430	235	303	573	69	2521	13.62
Ashkali & Egjiptas	0	533	882	1182	593	727	466	312	195	4890	26.44
Goranë	57	0	149	393	479	250	93	88	32	1541	8.33
Boshnjakë	3	0	73	145	141	125	139	234	86	946	5.11
Shqiptarë	0	27	249	245	8	49	53	15	32	678	3.66
Gjithsej	1906	1453	2709	3802	2469	2126	1669	1802	569	18,505	100

Në vitin 2009 besohet se rajoni i Mitrovicës kishte numrin më të madh të personave të zhvendosur në Kosovë. Siç paraqitet në Tabelën 2, 7,008 serbë që aktualisht jetojnë në Mitrovicë janë të zhvendosur nga shtëpitë e tyre në jugun e Mitrovicës dhe komunat tjera në veriun e Mitrovicës. Ngjashëm, 7,458 shqiptarë janë zhvendosur nga veriu i Mitrovicës dhe tani banojnë në jugun e Mitrovicës.¹⁸⁸

Tabela 2. Personat e zhvendosur që banonin në Mitrovicë në maj të vitit 2009, të ndarë sipas etnisë¹⁸⁹

Rajoni i zhvendosjes	K/S	K/Sh	Ashkali	Boshnjak	Goranë	Kroat	Egjiptian	Turq	Të tjerë	Gjithsej
Mitrovicë	7008	7458	218	540	5	15	0	24	11	15,279

Në tabelën 3 prezantohet numri i të kthyerve në Mitrovicë sipas etnisë: 568 serbë (të kthyer në veri të Mitrovicës), 482 romë, 335 shqiptarë, 390 egjiptianë dhe ashkali, 40 boshnjakë dhe një goran janë kthyer në shtëpitë e tyre në Mitrovicë.

¹⁸⁷ MKK, "Strategjia për Komunitete dhe Kthim 2009-2013", e cila nuk është miratuar nga Qeveria e Kosovës.

¹⁸⁸ UNHCR, "Pasqyrë Statistikore", OCM Prishtinë, Maj 2009.

¹⁸⁹ *Po aty.*

Tabela 3. Numri i gjithmbarshëm i personave paraprakisht të zhvendosur që janë kthyer në Mitrovicë¹⁹⁰

Grupi etnik	Shqiptarë	Serbë	Romë	Egjiptianë dhe Ashkali	Boshnjakë	Goranë	Gjithsej
Mitrovicë	335	568	482	390	40	1	1,816

Po shqiptarët?

Nga viti 2000, rreth 7,458 shqiptarë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre në Mitrovicë (shih Tabelën 2). Kthimi i shqiptarëve në veriun e Mitrovicës vazhdon të paraqesë një çështje serioze. Edhe pse të kthyerve serbë dhe romë i është ofruar mjaft përkrahje, disa organizata ndërkombëtare hezitojnë të përkrahin dhe të mundësojnë kthimin në veri. Para investimit në procesin e kthimit, Programi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNDP) matë nivelin e rrezikshmërisë për të kthyerit. Pasi që ky nivel i rrezikshmërisë në veri është vlerësuar të jetë “mesatar,” UNDP nuk ka ndihmuar procesin e kthimit atje. Sipas përfaqësuesit të tyre “Organizata e Kombeve të Bashkuara nuk lejon të ndihmohet në këtë drejtim në rajone që konsiderohen të rrezikshme.”¹⁹¹ Në një deklaratë të ngjashme, një zyrtar i UNHCR shtoi, “Në veriun e Mitrovicës ne nuk mund të ofrojmë ndihmë për kthim të shqiptarëve, ngase OKB vlerëson se pjesa veriore nuk është vend i sigurt për të jetuar.”¹⁹²

Kthimi i shqiptarëve në veriun e Mitrovicës nuk ka paraqitur prioritet as për Qeverinë e Kosovës. Tek në vitin 2008 Qeveria ka filluar procesin e kthimit të shqiptarëve në pronat e tyre. Procesi tashmë është përballë me barriera të shumta. Në lagjen Kroin e Vitakut në veriun e Mitrovicës, autoritetet komunale kanë ndërtuar më shumë se njëzet shtëpi. Deri në fund të vitit 2010 do të ndërtohen edhe 24 shtëpi të tjera. Disa familje shqiptare veçse janë kthyer, ndërsa disa të tjera planifikojnë të kthehen në të ardhmen e afërt. Pesë shtëpi tjera janë ndërtuar në Mëhallën e Boshnjakëve.

Në fillim të muajit dhjetor katër familje shqiptare janë kthyer në shtëpitë e tyre të rindërtuara në Kroin e Vitakut. Ish-Kryetari i Komunës së Mitrovicës z. Rexhepi ka deklaruar se në pjesën veriore janë rreth 200 shtëpi të shkatërruara dhe se në 2-3 vitet në vijim do të përfundojë edhe rinovimi i shtëpive në komunën e Zveçanit.¹⁹³

Rindërtimi i shtëpive shqiptare në Kroin e Vitakut nuk është mirëpritur as nga serbët që jetojnë në veri e as nga UNMIK-u. Rreth 100 serbë nga veriu i Mitrovicës protestuan kundër rindërtimit të shtëpive për shqiptarët në Kroin e Vitakut.¹⁹⁴ Sipas ish-Kryetarit të

¹⁹⁰ Po aty.

¹⁹¹ Intervistë me Afërdita Surroin, Zëvendëskoorindatore e Projektit SPARK IR, UNDP, tetor 2009.

¹⁹² Intervistë e IKS-it me zyrtarë të UNHCR, tetor 2009, Mitrovicë.

¹⁹³ Gazeta Express, “Në Kroin e Vitakut, kthehen familjet e para”, 4 dhjetor 2009.

<http://www.gazetaexpress.com/web/index.php/artikujt/lexo/20278/C4/C15>

¹⁹⁴ Gazeta Express, “Fillojnë edhe njëherë.”

<http://www.gazetaexpress.com/index.php/artikujt/lexo/14893/C4/C15/>

Komunës së Mitrovicës, z. Bajram Rexhepi, rindërtimi i rrugës nga Suhodolli deri tek Kroji i Vitakut në veri është ndërprerë disa herë nga UNMIK-u.¹⁹⁵ Për dallim nga policia e UNMIK-ut, në pranverën e vitit 2009 policia e EULEX-it nuk janë përkulur para protestave të dhunshme por kanë ofruar siguri që të vazhdojnë ndërtimet.¹⁹⁶

Edhe pse Qeveria e Kosovës ka shënuar përpjekje për të siguruar kthimin e shqiptarëve në pronat e veta në veriun e Mitrovicës, duket se ky proces nuk është planifikuar shumë mirë. Siç u cek edhe më lartë, siguria në veri paraqet një çështje brengosëse për shqiptarët që duan të kthehen. Qeveria e Kosovës duhet t'i ikë improvizimit dhe politizimit të procesit të kthimit dhe në vend të kësaj duhet të planifikojë kthimin e sigurt të të gjithëve, pa marrë parasysh etninë e tyre.

Konkludim

Përkundër sfidave të shumta të cilat janë hasë deri me tani, procesi i kthimit, i iniciuar nga Komuna e Mitrovicës dhe me përkrahje financiare nga Qeveria e Kosovës, ka lëvizur përpara. Është arritur një progres i caktuar dhe siç komentoi Ylber Hysa, Këshilltar Politik i Kryetarit të Komunës së Mitrovicës “deri në vitin 2008, kthimi i shqiptarëve të Kosovës në Mitrovicën e veriut ka qenë i pamundur, ndërsa tani është një proces i vështirë.”¹⁹⁷

Që nga shpallja e pavarësisë në shkurt të vitit 2008, gjërat sa i përket kthimit kanë filluar të lëvizin përpara edhe pse me shpejtësi kërmilli. Ngritja modeste e pjesëmarrjes së serbëve në zgjedhjet lokale të Kosovës në muajin nëntor 2009 paraqet një shenjë inkurajuese. Sidoqoftë, duket se ndikimi i Beogradit dhe perceptimet e caktuara mbi sigurinë po ndikojnë në vendimet e tyre për kthim. Ngecja ekonomike dhe mungesa e perspektivës së punësimit duket se paraqesin pengesat kryesore ndaj kthimit të qëndrueshëm, ndërsa siguria duket më shumë një barrierë psikologjike për serbët e Kosovës.

Investimi në ekonominë e Mitrovicës dhe krijimi i një programi ekonomik special për këtë qytet, i cili do ta shndërronte atë në zonë speciale ekonomike me qëllim të rimëkëmbjes së tij, paraqesin mënyrën më të sigurt për integrimin e qytetit. Të gjitha palët me interes, qeveria lokale dhe qendrore, donatorët dhe shoqëria civile do duhej të angazhohen në ofrimin e ideve për biznese të vogla efektive të cilat do të ndihmonin kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur duke u fokusuar në nevojat e komunitetit por edhe duke shfrytëzuar përvojat e tyre dhe zanatet e tyre tradicionale. Mundësitë si “Hotel Industria” paraqesin shembuj konkretë të inkurajimit të kthimit të qëndrueshëm dhe integritit të komuniteteve.

¹⁹⁵ Koha Ditore, “Pengohet realizimi i projektit të rrugës Suhodoll – Kroji i Vitakut,” 20 nëntor 2009.

¹⁹⁶ Po aty.

¹⁹⁷ Intervistë e IKS me Ylber Hysën, tetor 2009, Mitrovicë.

Përmirësimi i shërbimeve publike dhe arsimimit janë po aq të rëndësishme për kthim të qëndrueshëm. Kthimi i personave të zhvendosur në shtëpitë e tyre nuk varet nga një sektor i vetëm dhe nuk është problem që shquhet si i vetëm, por është i natyrës që duhet të trajtohet nga kënde të ndryshme në mënyrë që të krijohen kushte për kthim të sigurt dhe të qëndrueshëm.

IKS beson se ka shumë më shumë elemente që bashkojnë të dy komunitetet që jetojnë në Mitrovicë se sa të tilla që i ndajnë ato. Zhvillimi ekonomik, arsimimi i mirë, punësimi, shërbimet publike dhe zvogëlimi i varfërisë janë probleme të cilat do duhej konsideruar si prioritare nga institucionet publike.

Adresimi i këtyre problemeve duhet të ndihmojë në krijimin e mirëbesimit të ndërsjellë mes komuniteteve të Mitrovicës i cili është i domosdoshëm për kthimin dhe integrimin e sigurt të komuniteteve në jetën publike në Kosovë.

TRASHËGIMIA E MITROVICËS: PASURI E PËRBASHKËT APO BARRË?

“Identifikimi i trashëgimisë kulturore në Kosovë do të arrihet duke theksuar unitetin e saj, pa marrë parasysh identitetin kulturor të saj. Megjithatë, të kuptuarit e vlerave kulturore të të gjitha komuniteteve në Kosovë duhet shtjelluar brenda kontekstit të diversitetit dhe tolerancës.”

– Ligji për Trashëgiminë Kulturore 2006

Trashëgimia kulturore e Mitrovicës është transformuar krahas sfidave të ndryshme politike dhe sociale të përjetuara në mënyrë të dyfishtë nga shoqëria Kosovare, duke u përcjellë nga ridefinimi i kufijve, rishpërndarja e njerëzve dhe nevoja për mirëkuptim të ndërsjellë mes kulturave të ndryshme, në nivele të ndryshme të shoqërisë. Dy dekadat e fundit e kanë lënë trashëgiminë e Mitrovicës në gjendje të rëndë neglizhence. Humbja e trashëgimisë kulturore paraqet një kërcënim të madh për historinë kulturore dhe diversitetin e rajonit, si dhe rrezikon humbjen e mundshme të bazës së fortë mbi të cilën duhet ndërtuar e ardhmja e përbashkët.

Diversiteti kulturor në Mitrovicë është dëshmuar t’i ngjajë më shumë një pengese. Gjatë konfliktit të vitit 1999, u dëmtuan 19 objekte, pjesë e trashëgimisë kulturore, përfshirë dy kinema, dy qendra kulture, një monument i trashëgimisë kulturore, nëntë kulla, katër xhami dhe një teqe.¹⁹⁸ Gjatë trazirave të marsit të vitit 2004 u dogj kisha ortodokse Shën Sava.¹⁹⁹

Promovimi i tolerancës kulturore ka qënë i pamundur të realizohet. Në të gjitha aspektet praktike veriu i Mitrovicës dhe jugu i Mitrovicës janë të ndara, dhe asnjëra prej komunave nuk njeh legjitimitetin e tjetrës. Trashëgimia kulturore si vlerë e përbashkët mbetet një synim i largët. Organet administrative paralele në këtë qytet pa dyshim që nuk e bëjnë më të lehtë mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë së përbashkët kulturore.

Megjithatë, politika aktuale nuk do të thotë se diversiteti kulturor nuk mund të jetë aset, sidomos kur merret në konsideratë tradita e hershme e tolerancës kulturore në Mitrovicë. Një vizitë në Muzeun e Qytetit ilustron historinë e pasur dhe të shumëllojshme kulturore të qytetit. Një koleksion permanent i kostumeve tradicionale, stolive dhe sendeve të tjera të përditshme dëshmon mbi faktin se grupe të ndryshme etnike kanë jetuar në Mitrovicë

¹⁹⁸ Komisioni Evropian (KE), *Vlerësimi i Dëmit në Kosovë*, Grupi për Menaxhim Ndërkombëtar (IMG), *Vlerësim i Ndërtimit të Kosovës, Komuna e Mitrovicës*, prill 2000.

¹⁹⁹ Konflikti i vitit 1999 solli dëmtim të madh të monumenteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë: u shkatërruan më se 200 xhami, 450 kulla, qindra shtëpi urbane, një sërë kishash katolike nga shekulli XIX dhe XX. Gjatë trazirave të marsit 2004, rreth 37 monumente ortodokse u dëmtuan apo u shkatërruan; nga to dhjetë ishin të vlerësuara si monumente të trashëgimisë kulturore dhe ishin në mbrojtje ligjore, ndërsa mes të tjerave ishin edhe disa monumente ortodokse nga gjysma e dytë e shekullit XX. Baki Svirca, *Mbrojtja Moderne e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë*, në Raportin e Takimit Rajonal të Ekspertëve të Mbrojtjes së Trashëgimisë Kulturore përmes Bashkëpunimit Rajonal në Arsim, Transferim të Njohurive dhe Teknologjisë, të mbajtur në Shkup/Stokholm në shator/nëntor të vitit 2006.

njëri pranë tjetrit: Çifutët, Shqiptarët, Serbët, Boshnjakët, Turqit, Goranët, e të tjerë. Pamja e qytetit tregon një arkitekturë të pasur dhe të shumëllojshme. Ndërtesat e stilit otoman janë të ngërthyera me arkitekturën austrohungareze; ndërsa të dyja këto tani mëtojnë të konkurrojnë me ndërtesat e reja dhe moderne. Ky fakt pasurohet me stilet angleze dhe gjermane, të pranishme sot në pamjen arkitekturore të Mitrovicës. Në vitet 1920, kur kompania angleze Selection Trust shpk ishte përgjegjëse për menaxhimin e Trepçës, shtëpi minatorësh u ndërtuan në Stari Trg. Kompleksi i parë i banesave u ndërtua nga pushtimi fashist gjerman gjatë luftës së dytë botërore.

Edhe pse historikisht në Mitrovicë kanë jetuar kultura të ndryshme të lashta,²⁰⁰ Mitrovica e sotme shpreh shumë pak nga kjo trashëgimi. Vetëm nëntë monumente janë marrë në mbrojtje që prej një gjysmë shekulli. Asnjë monument nuk ka fituar statusin e monumentit të mbrojtur që nga viti 1980. Monumentet e mbrojtura kanë filluar të rënohen, ndërsa monumentet e inventarizuara apo ato të paidentifikuara së shpejti mund të humben tërësisht. Trashëgimia kulturore e Mitrovicës mbetet një çështje me gjemba, që mban mbi supë barrën e viteve të neglizhencës.

Një mori ligjesh, kush është kompetent?

Neglizhenca e theksuar pothuajse është bërë normë për një pjesë të mirë të trashëgimisë së Kosovës. Legjislacioni ekzistues dhe politikat për identifikimin, mbrojtjen dhe kontrollimin e aseteve trashëgimore ende nuk është implementuar në tërësi, shkak ky i ngatërresës institucionale mbi kompetencat.

Deri në vitin 2006, moria e ligjeve mbi trashëgiminë kulturore përfshinte tre korniza legjislative: ligjin e vitit 1977 mbi Mbrojtjen e Monumenteve Kulturore,²⁰¹ legjislacionin e Qeverisë së Serbisë prej vitit 1989, si dhe legjislacionin e miratuar nga UNMIK-u pas vitit 1999. Në nëntor të vitit 2006, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin mbi Trashëgiminë Kulturore, i hartuar nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Ligji thekson rëndësinë e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore por nuk qartëson se ku qëndron përgjegjësia për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Rrjedhimisht, ky ligj i kontribuon ngatërresave, për shkak se asnjë institucion nuk e ka të qartë rolin e vet përkatës, duke krijuar në këtë mënyrë një bazë për kompetenca paqartësisht të ndara mes institucioneve komunale dhe atyre qendrore. As amandamentimi i shtatë akteve nënligjore mbi trashëgiminë kulturore nuk e ka zgjidhur këtë paqartësi ekzistuese. Në fakt, ato kanë gjeneruar po të njëjtat probleme.

²⁰⁰ Në territorin e Mitrovicës janë zbuluar tri vendbanime të epokës neolitike: Zhitkovci, Fafosi dhe Vallaci. Vendbanimi afër Zhitkovcit i përket kulturës Sarcevac të epokës më të hershme neolitike, nga fillimi i mileniumit të 5-të para epokës sonë. Instituti i Historisë së Kosovës, Këshilli për Botimin e Monografive, *Mitrovica dhe Rrethina*, Mitrovicë, 1979, f.431.

²⁰¹ Miratuar nga Kuvendi i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës në vitin 1977.

Këshilli i Kosovës për Trashëgimi Kulturore, i paraparë me nenin 4.8 dhe 4.9 u themelua në vitin 2007 por ende nuk është bërë funksional.

Lista e monumenteve të trashëgimisë kulturore nën mbrojtje permanente, që duhet të përcaktohet nga një ‘institucion kompetent’ i paspecifikuar, ende nuk është publikuar.²⁰² Monumentet deri tani nuk i janë nënshtruar ndonjë kontrolli qeveritar. Deri me sot, inspektorët e trashëgimisë kulturore, përgjegjës për vlerësimin e kushteve dhe gjendjes për sa i përket ruajtjes së trashëgimisë kulturore, ende janë individë fiktivë që ekzistojnë vetëm në letër. Asnjë nga institucionet nuk duket se përcjell me detaje se çfarë po ndodh me monumentet e mbrojtura me ligj.²⁰³

Lista e Mitrovicës

Mitrovica, ky vendbanim i hershëm që prej epokës së neolitit, dhe strehë e kulturave të ndryshme Ilire, Romake, Bizantine dhe Otomane, sot paraqet pak dëshmi nga kjo e kaluar e pasur. Edhe këtu, monumentet e trashëgimisë kulturore nuk kanë arritur t’i shmangen praktikës së përgjithshme së neglizhencës.

Mitrovica ka nëntë monumente të mbrojtura:

1. Hamami i qytetit
2. Kisha katolike Shën Pjetri
3. Xhamia me varre
4. Rrënojat e qytetit mesjetar të Trepçës
5. Gjyteti i Trepçës
6. Rrënjat e kompleksit mesjetar në sipërfaqen e Trepçës së vjetër
7. Shtëpia në rrugën Ilija Bircani
8. Shtëpia e Bllagoje Gjorgjeviqit
9. Shtëpia në rrugën Zelengora

²⁰² Kosova ka 426 kisha, monumente dhe lokacione arkeologjike nën mbrojtje dhe 2,800 monumente kulturore të tjera në listën e inventarit që pret të vlerësohet. Një listë prej 425 monumentesh që meritojnë “mbrojtje” është sajuar në bazë të Ligjit mbi Monumentet Kulturore të vitit 1977, dhe përfshin 136 kisha ortodokse, si dhe rrënoja e ikona të tyre; 96 lokacione dhe monumente arkeologjike; 42 rezidenca; 28 kulla tradicionale; 23 xhami dhe rrënoja të tyre; 16 varreza; 10 teqe dhe mauzole tjera myslimane; dhe 72 monumente dhe artefakte tjera, përfshirë shtatë ura, tri kisha katolike, gjashtë hamame, tri pazare, libra, veshje dhe objekte tjera. E njëjta listë përdoret dhe sot vetëm me një ndryshim të vogël; në vitin 2003, Instituti Kosovar për Mbrojtjen e Monumenteve i shtoi kësaj liste edhe shtëpinë e priftit shqiptar Shtjefën Gjeçovi.

²⁰³ Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) dhe Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI), *Një e ardhme për të kaluarën e Prishtinës*, Prishtinë, 2006.

Kjo listë e shkurtër në asnjë mënyrë nuk e përfaqëson denjësisht trashëgiminë e pasur të njërës nga vendbanimeve më të vjetra të Kosovës.

Në vjeshtën e vitit 2009, Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS) është përpjekur të përcaktojë vendndodhjen e nëntë monumenteve të mbrojtura të Mitrovicës, për të parë nga afër gjendjen aktuale të tyre. Ky udhëtim nëpër Mitrovicë, përfshiu përpjekjet për të gjetur adresat e përcaktuara në listën zyrtare, të cilat nuk përkonin më me emrat e rrugëve. Ndërkohë që një nga monumentet e mbrojtura u gjet i shkatërruar tërësisht, të tjerat ishin në gjendje të mjerë, si paraqitet në paragrafet në vijim.

Hamami i qytetit (marrë nën mbrojtje në vitin 1957)



Hamami i Mitrovicës daton nga shekulli XVIII. Dikur përbente një pjesë esenciale të qendrës së qytetit të vjetër otoman. Sipas pronarëve të tij, hamami ishte ndërtuar nga Sulejman Pashë Berisha dhe nipi i tij Zejnullah Beg Berisha. Ndërtimi i kësaj banjoje me stil tipik oriental zgjati dy vite. Hamami ishte funksional deri në maj të vitit 1959. Disa muaj më pas, Muzeu dhe Arkivat e qytetit u vendosën brenda premisave të hamamit. Për gjysmë shekulli, Muzeu i Mitrovicës i vendosur në të ofronte një ekspozitë interesante të veglave nga epoka neolitike brenda kësaj banjoje të vjetër otomane. Kulmi i hamamit është riparuar kohëve të fundit, në maj të vitit 2009, nga UNESCO.²⁰⁴ Përveç problemeve me sistem të drenazhit, hamami është në përgjithësi në gjendje të mirë.


²⁰⁴ Në 7 maj 2009, *Cultural Heritage without Borders (CHwB)* dhe Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë (UNESCO) nënshkruan një kontratë mbi restaurimin e hamamit të Mitrovicës, në mënyrë që të sigurohen kushtet e duhura për prezervimin afatgjatë të këtij monumeti. Ky aktivitet ndërmerret si pjesë e projektit të UNESCO-s “Ruajtja e Trashëgimisë Kulturore në Kosovë” (financuar me fonde të siguruar nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës), i cili i dedikohet mbrojtjes dhe rehabilitimit të disa lokacioneve dhe monumenteve të trashëgimisë kulturore në Kosovë.

Kisha katolike Shën Pjetri (marrë nën mbrojtje në vitin 1958)



Kisha katolike Shën Pjetri, e njohur gjithashtu si kisha SASE, daton nga shekulli XIII. Ajo ishte ndërtuar për minatorët saksonë dhe tregtarët katolikë që tregtonin në qytetin e Trepçës. Sot, rrënojat e saj gjenden në qytetin e vjetër të Stari Tërgut, i njohur gjithashtu si “Trepça Turke” për shkak të vendosjes së kolonëve turq nga shekulli XIV. Sot kësaj kisha i ka mbetur vetëm një mur. Themelet e kishës aludojnë për bukurinë dhe arkitekturën e dikurshme. Rreziku i degradimit të mëtejshëm të strukturës ekzistuese vlerësohet si i lartë.

Xhamia me varre (marrë nën mbrojtje në vitin 1966)



Xhamia me varre me vendndodhje në fshatin Mazhiq, është ndërtuar në shekullin XIV për komunitetin mysliman. Përreth gjenden shumë pak dëshmi të mbetura nga ndërtesat e tjera publike të kesaj periudhë, si hamami, premiset për karavane, shitoret, hanet dhe rrënojat e varrezave myslimane. Në xhami vërehen efektet e kohës; nuk ka mbetur asgjë përveç mureve gjysëm të rëna. Nuk ka asnjë gjurmë të minaresë apo kupolës së saj.

Rrënojat e qytetit mesjetar të Trepçës (marrë nën mbrojtje në vitin 1966)

Qyteti mesjetar i Trepçës daton nga shekujt XIII dhe XIV. Rrënojat e qytetit gjenden në vendndodhjen që sot njihet si fshati Vidishiq. Qyteti është zhvilluar me shpejtësi gjatë mesjetës nën pushtetin e Serbisë, me shfrytëzimin e minierave dhe me përpunimin e xeheve të argjendit, arit dhe çelikut. Kjo qendër e rëndësishme minerare dhe komerciale e Ballkanit zhvillonte marrëdhënie aktive tregtare me qytetet bregdetare përgjatë tërë Detit Adriatik, në veçanti me Dubrovnikun dhe Kotorin. Në atë kohë, Dubrovniku kishte përfaqësi permanente konsulare në Trepçë.

Rrënojat e kompleksit mesjetar të Trepçës së vjetër (marrë nën mbrojtje në vitin 1967)

Kompleksi mesjetar i Trepçës së vjetër daton nga shekujt XIV-XVI. Besohet se Trepça është themeluar nga minatorët saksonë. Banjska Karta²⁰⁵ (1313-1316) dëshmon praninë e saksonëve në Trepçë. Në mesin e shekullit XIV, në Trepçë gjithashtu jetonin banorë sllavë dhe latinë.

Gjyteti i Trepçës (marrë nën mbrojtje në vitin 1966)

Gjyteti i Trepçës, daton nga shekujt XIII dhe XIV. Gjyteti ishte ndërtuar pranë minierave, sipër lumit të Sremkovnicës. Ai shërbente si fortifikatë krahas asaj të Zveçanit, duke mbrojtur kësisoj vendbanimet pranë minierës në kohë të trazirave. Gjyteti nuk dihet të ketë pasur vendbanim. Fortifikata modeste duket të ketë luajtur ekskluzivisht rol strategjik.²⁰⁶ Një pjesë e vogël e kësaj fortifikate ndodhet pranë fshatit malor Rashan.

Shtëpia e Koroğlu në rrugën Ilia Bircani (marrë nën mbrojtje në vitin 1978)



Shtëpia tradicionale e familjes Koroğlu²⁰⁷ daton nga mesi i shekullit XIX. Ajo ndodhet pranë qendrës së qytetit të vjetër otoman në lagjen që tani njihet si “Kaçamak Mahalla.” Kjo shtëpi tipike otomane është ndërtuar nga familja Koroğlu para afro 200 vitesh. Për shkak të gjendjes jo të mirë, kjo shtëpi nuk përdoret më nga familja. Ergin Koroğlu, ish-Zëvendësministër për Kulturë, Rini dhe Sport, është pronar i shtëpisë, ndërsa familja e tij jeton në ndërtesën fqinje. Shtëpia ka ruajtur strukturën origjinale por mund të mos mbijetojë edhe gjatë nëse nuk riparohet. Adresa e dhënë në listën e monumenteve të mbrojtura nuk korrespondon me emrin e ri të rrugës, i ndryshuar në Rruga Ferat Dragaj në vitet 1999 dhe 2000.

²⁰⁵ Banjska Karta është një dokument i rëndësishëm juridik i shtetit feudal të Serbisë në mesjetë.

²⁰⁶ Këshilli për Botimin e Monografive, *Mitrovica dhe Rrethina*, Mitrovicë 1797.

²⁰⁷ Koroğlu në turqisht do të thotë “i biri i të verbrit”.

Shtëpia e Bllagoje Gjorgjeviqit (marrë nën mbrojtje në vitin 1980)



Në vjeshtë të vitit 1941, në shtëpinë e Bllagoje Gjorgjeviqit u themelua Këshilli i Fondit Rajonal Nacionalçlirimtar, një institucion që grumbulloi mjete financiare dhe materiale për Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Bllagoje Gjorgjeviq, pronar i shtëpisë, udhëhiqte me këtë këshill. Bodrumi i shtëpisë shërbente si vendstrehim gjatë luftës nacionalçlirimtare. Gjorgjeviqi dhe i biri i tij u arrestuan nga Gestapo në vitin 1944.²⁰⁸ Pas luftës, kjo shtëpi u shndërrua në muze. Shtëpia është e vendosur në Mitrovicën e veriut.

Shtëpia në rrugën Zelengora (marrë nën mbrojtje në vitin 1980)



Ndërtesa e ish-konsullatës Ruse në Mitrovicë daton nga fillimi i shekullit XX. Grigori Stepanovich Shcherbin, konsulli Rus është vrarë në atë ndërtesë gjatë një revolte të më se 2,000 protestuesve shqiptarë që sulmuan garnizonin otoman. Shtëpisë i është vënë zjarri në vitin 1999. Është rrafshuar me tokë në vitin 2003. Kjo ndërtesë është dëmtuar përtej çdo mundësie për riparim.²⁰⁹

²⁰⁸ Sulejman Murati, *Dëshmitë e Luftës për Liri*, 1986, f. 129-130.

²⁰⁹ Rrugës Zelengora më pas i është ndërruar emri në Rruga Kemal Atatürk.

Trashëgimia në Rrezik

Iniciativa për të përpiluar një inventar të ri të trashëgimisë kulturore të Kosovës nisi në vitin 2001. Nga 2,800 monumente dhe vende të identifikuar, rreth 100 prej tyre ndodhen në Mitrovicë dhe janë në pritje nëse i'a 'vlen' të mbrohen.

Cultural Heritage without Borders (CHwB), organizatë ndërkombëtare që përpiket të mbrojë monumentet të rrezikuara kulturore, ka identifikuar 100 objekte të tilla në Kosovë. 15 nga to gjenden në rajonin e Mitrovicës, përfshirë këtu tre monumente kulturore të mbrojtura.²¹⁰ Sali Shoshi, Drejtor i CHwB, shpreh shqetësim lidhur me shkatërrimin e shpejtë të trashëgimisë kulturore në Kosovë mes viteve 2002 dhe 2007, sidomos duke patur parasysh investimet krahasimisht të vogla që janë bërë për riparimin dhe ruajtjen e tyre.²¹¹

Neglizhenca dhe shkatërrimi i përshpejtuar kanë ndodhur posaçërisht në dekadën e fundit. Në Mitrovicë, një monument i mbrojtur – ndërtesa e ish-konsullatës Ruse, është shkatërruar plotësisht për t'i lënë vend një autolarjeje. Monumentet e tjera janë duke u dëmtuar çdo ditë. Nëse neglizhenca dhe shkatërrimi i trashëgimisë kulturore vazhdojnë me këtë ritëm, Mitrovica nuk do të ketë çfarë të mbrojë sa i përket trashëgimisë. Edhe nëse do të rindërtoheshin monumentet e shkatërruara, një pjesë e mirë e trashëgimisë së tyre do të ketë humbur përgjithmonë.

Trashëgimia kulturore është një nga pikat e mbuluara nga asistenca që ofrohet para hyrjes në BE. Si e tillë, institucionet e Kosovës urgjentisht duhet të ofrojnë zgjidhje për paqartësitë legjislativë dhe administrative sa i përket trashëgimisë kulturore dhe duhet të dëshmojnë aftësinë dhe vullnetin e tyre për të zbatuar standardet evropiane dhe për të implementuar ligjin e aplikueshëm.

Vetëdijësimi i opinionit publik është element kyç për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ndërsa mënyra më e mirë për ta rritur atë është promovimi i rëndësisë sociale dhe ekonomike që gëzon trashëgimia. *Tour de Culture*, e pagëzuar si “Trashëgimia mbi Dy Rrota” është një ekskursion me biçikleta, që synon promovimin e vlerave kulturore dhe natyrore të Kosovës. Për të dytën herë këtë vit, gjatë muajit tetor çiklistët shëtiten juglindjen e Kosovës, dhe ndaluan në disa vende kulturore gjatë rrugës. “Qëllimi ynë është t'i mbrojmë ato, të ruajmë vlerën e tyre”, deklaroi për *Prishtina Insight* Rexhep Balliu, udhëheqës i Klubit të Çiklizmit Prishtina. “Përndryshe s'do të kemi histori. Këto monumente na tregojnë se kush jemi dhe ne duhet të jemi krenarë me to.”²¹² Ndoshta vitin e ardhshëm Mitrovica mund të jetë një nga stacionet e këtyre çiklistëve.

²¹⁰ *Cultural Heritage without Borders* (CHwB), “Trashëgimia në rrezik: Ridefinimi i vlerave kulturore përmes trashëgimisë së ndërtuar në Evropën juglindore”, publikimi pritët në dhjetor 2009.

²¹¹ *Koha Ditore*, “Trashëgimia Kulturore: Pse Kosova nuk bën më shumë?”, e shtunë 7 nëntor 2009. f. 58.

²¹² Rexhep Balliu, udhëheqës i Klubit të Çiklizmit Prishtina, i cituar nga Arif Muharremi, “Heritage on Two Wheels” (Trashëgimia mbi Dy Rrota), *Prishtina Insight*, tetor 2009, f.9

Aktivitetet e kësaj natyre ndihmojnë gjithashtu në zbulimin e vendeve të tjera potencialisht të përshtatshme për turizëm, e Mitrovica ka shumë të tilla. Trashëgimia industriale e Mitrovicës mund të shërbejë si aset në përpjekjet për të ringjallur industrinë e turizmit. Muzeu i Kristaleve në qytetin e Stan Tërgut tashmë ekspozon shumë xehe minerale të rralla nga minierat e Trepçës. Artefakte nga ky muze janë ekspozuar dhe jashtë Kosovës. Kompleksi i Trepçës në Zveçan do të mund të transformohej në një muze industrial.

Sidoqoftë, mbrojtja e trashëgimisë së përbashkët nuk do të jetë e plotë pa tolerancë për diversitetin kulturor. Ura të komunikimit do duhet të ndërtohen mes komuniteteve të largëta me njëra-tjetrën.

Planet që Mitrovica të jetë qyteti mikpritës i Forumit për Qytete në Tranzicion nga Konflikti për vitin 2010, ofron një mundësi për të përmirësuar dialogun mes veriut dhe jugut. Ministri i Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, z. Sadri Ferati, dhe Presidenti i Lëvizjes Qytetare për Mitrovicën e Kosovës, Dragan Spasojeviq, shokuan Universitetin e Masaçusetsit në Boston kur shprehën interesin e tyre të përbashkët për të qenë mikpritësit e forumit të parë të tillë në Mitrovicë. Si rezultat i kësaj, Universiteti i dekoroi me Medaljen e Kancelarit për Paqe dhe Pajtim Ndërkombëtar.²¹³

Përpjekje të ngjashme do të mund dhe do të duhet të inkurajoheshin nga liderët komunalë dhe shtetërorë, si dhe nga grupet e shoqërisë civile. Së bashku, këto palë duhet të përpiqen të përfshijnë komunitetin dhe rininë lokale në evenimente kulturore, vizita të monumenteve dhe vendeve kulturore, turne edukative dhe në krijimin e pikave turistike, të cilat do të rrisnin vetëdijen dhe do të çmojnë më shumë trashëgiminë e përbashkët. Investimet fillestare në industrinë e turizmit gjithashtu do të mund të joshin më shumë turistë në të ardhmen, duke mundësuar kështu gjenerim të të ardhurave për ruajtjen e monumenteve dhe artefakteve kulturore.

²¹³ Z. Ferati dhe z. Spasojeviq ishin në cilësinë e përfaqësuesve të qytetit të Mitrovicës mes tridhjetë delegatëve nga qytete tjera të ndara si Nikozia (Qipro), Kirkuk (Irak) dhe Derry/Londerry (Irlanda e Veriut). Delegatët u pajtuan që të marrin pjesë në këtë mundësi unike për krijimin e një forumi permanent për dialog.